



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 51/2024 regjistër (JR)  
Datë 11.12.2024

Nr. 4 i vendimit  
Datë 15.01.2026

VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Albana Shtylla</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Anëtar</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 15.01.2026, ditën e enjte, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Arjela Vllaçaj, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 792, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

**BAZA LIGJORE:** Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 42 dhe 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore; neni 46 e vijues të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”.

## Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

### VËREN:

#### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), me funksion prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet e hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”), dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar<sup>1</sup>, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për të justifikuar pasuritë*; (iii) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2 DSIK-ja vuri në dispozicion të Komisionit raportin për kontrollin e figurës<sup>2</sup> për subjektin e rivlerësimit, ku, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku.

2.3 KLP-ja, në përfundim të rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti gjatë periudhës objekt rivlerësimi, ka përcjellë pranë Komisionit raportin për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku.

3. Komisioni, pasi kreu një hetim administrativ të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret e rivlerësimit, në përfundim të procesit të rivlerësimit, arriti në këto konkluzione:

3.1. Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: [...]. *Subjekti nuk ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti ka rezultuar me pamundësi financiare në vlerën totale (-) 5.519.258 lekë për krijimin e pasurive, si dhe nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive të saj dhe të personit të lidhur. Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku nuk ka*

<sup>1</sup> Raporti i ILDKPKI-së, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 01.06.2020.

<sup>2</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. prot. {\*\*\*}, datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.10.2023, të KDZH-së.

arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të shkronjës “a”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.2. Për kriterin e kontrollit të figurës: [...] çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Ornela Rrumbullaku, ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të shkronjës “b”, të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

3.3. Për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale: [...], trupi gjykues nuk konstaton problematika që kanë lidhje me procesin e rivlerësimit të aftësive profesionale, të parashikuara nga neni 73 i ligjit nr. 96/2016.

4. Mbështetur në konkluzionet si më sipër, bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a”, dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 792, datë 04.09.2024, Komisioni ka vendosur: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë”.

## II. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit nr. 792, datë 04.09.2024, të Komisionit, ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, e cila e konsideron vendimin të dhënë në shkelje të parimeve të procesit të rregullt ligjor. Sipas pretendimeve të subjektit, vendimi është marrë në interpretim të gabuar të provave të administruara dhe të kuadrit ligjor të zbatueshëm. Për këto arsye, subjekti ka kërkuar nga Kolegji i Posaçëm i Apelit (në vijim “Kolegji”), kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore publike, ndryshimin e vendimit të Komisionit, dhe konfirmimin e saj në detyrë.
6. Bashkëlidhur ankimit, subjekti ka paraqitur aktin shkresor për ta administruar në cilësinë e provës: “Vërtetim për periudhë punësimi”, nr. {\*\*\*} prot., datë 02.09.2024, lëshuar elektronikisht nga Drejtoria e Arkivit Qendror pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në të cilin referohet se: “z. A. M., nga kontrolli i dokumentacionit që administrojmë deri tani për subjektin ‘{\*\*\*}’, me dosje nr. {\*\*\*}, është i siguruar për periudhën prill – maj 2009 dhe korrik – gusht 2009”. Ky vërtetim mban gjithashtu shënimin se: “Për muajin qershor dhe shtator nuk administrojmë listëpagesa”.
7. Më datë 07.01.2026, sikurse parashikon neni 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar, (në vijim “ligji nr. 49/2012”), subjekti i rivlerësimit paraqiti në Kolegji parashtrime me shkrim, duke pretenduar sipas nenit 32, paragrafi 2 i ligjit nr. 84/2016, pamundësinë objektive për të siguruar të dhëna të tjera mbi të ardhurat në shumën 4.800.000 lekë, të realizuara nga punësimi i bashkëjetuesit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA. Bashkëlidhur parashtrimeve, subjekti ka kërkuar të merren në cilësinë e provës këto akte shkresore:
- (i) Shkresa “Kthim përgjigje”, nr. {\*\*\*} prot., datë 14.11.2025, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë (në vijim “DRT”), drejtuar shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, përmes së cilës informon se, nga verifikimi i dokumentacionit kontabël të depozituar nga kjo shoqëri, në bilancin e vitit 2005 nuk disponohet informacion i detajuar mbi shpërndarjen e shpenzimeve për personelin, sipas individëve të angazhuar në cilësinë e konsulentit ligjor apo bashkëpunëtorit të jashtëm, që të mundësojë identifikimin dhe ndarjen specifike të vlerave, sipas çdo personi përfitues.

(ii) Shkresë informuese, datë 30.12.2025, e administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, z. V. K., i cili, ndër të tjera, deklaroi se nuk është objektivisht e mundur të vihet në dispozicion dokumentacion mbështetës për periudhën deri më 31.12.2005, pasi mungesa e tij është konstatuar edhe më parë, në kuadër të kontrollit të ushtruar në atë kohë nga Drejtoria e Tatimpaguesve të Mëdhenj. Bashkëngjitur kësaj shkrese, janë paraqitur në formë të noterizuar:

(a) Raport-kontroll, i datës 12.05.2008, i pasqyrave financiare të shoqërisë, si dhe procesverbali nr. {\*\*\*}, datë 21.04.2008, në të cilin inspektori tatimor përgjegjës referon se, për vazhdimin e kontrollit për vitin 2003, 2004 dhe 2005, nga ana e shoqërisë nuk është vënë në dispozicion dokumentacion, pasi shoqëria nuk e disponon.

(b) Raport-kontroll, i datës 12.05.2008, nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Njësia e Tatimpaguesve të Mëdhenj, si dhe disa procesverbale të mbajtura nga inspektori i tatimeve.

### III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

#### A. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

##### (a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, vendim të cilin, nëpërmjet ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon ta ndryshojë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas parashikimit të nenit 65 të ligjit nr. 84/2016.

##### (b) Legjitimimi i ankuesit

9. Subjekti i rivlerësimit legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës, nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

##### (c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të çështjes

10. Shqyrtimi i çështjes në Kolegji kryhet në përputhje me nenin 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016. Në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, zhvillohet në dhomë këshillimi. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 792, datë 04.09.2024, të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku, u mor në shqyrtim mbi bazë aktesh nga Kolegji në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 15.01.2026.
11. Trupi gjykues i Kolegjit, fillimisht analizoi shkaqet procedurale të ankimit, të ngritura nga subjekti i rivlerësimit, që kanë të bëjnë me procesin e rregullt ligjor të kryer pranë Komisionit, të cilat konsistojnë në:

11.1. *Shkelje të nenit 6, pika 1 e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”) dhe nenit 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Shkelje të së drejtës për siguri juridike për mosrespektimin e jurisprudencës së Komisionit dhe Kolegjit, shkeljen e parimit të ligjshmërisë për shkak të ekzistencës së gjykimeve të kundërta dhe, si rrjedhojë, shkelje të nenit 8 për respektimin e jetës private nga Komisioni.* Sipas subjektit, në kundërshtim me pritjet e saj legjitime, Komisioni nuk ka marrë në konsideratë parimet që ka zbatuar në raste të tjera, si dhe nuk ka dhënë arsye bindëse për largimin e tij nga praktikat e mëparshme gjyqësore. Ndonëse subjekti pranon se jurisprudenca nuk është statike, pretendon se çdo shmangie nga qëndrimet e mëparshme të gjykatës duhet të shoqërohet me argumentim thelbësor të arsyeve të largimit nga qëndrimet e mëparshme<sup>3</sup>. Në konsideratë të disa vendimeve të Komisionit dhe të Kolegjit,<sup>4</sup> subjekti i rivlerësimit pretendon për shmangie nga jurisprudenca e mëparshme në rastin e subjektit të rivlerësimit, sa i takon vlerësimeve lidhur me: (i) përfshirjen në analizën financiare të të ardhurave të familjes së bashkëshortit, me burim nga aktiviteti bujqësor; (ii) përfshirjen në analizë të të ardhurave të ligjshme, në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës; (iii) mosndëshkimin për pasaktësitë e konstatuara në deklaratimet periodike vjetore, të pashoqëruara me pamjaftueshmëri financiare, si dhe (iv) mosnjohjes së të ardhurave nga punësimi, për shkak të përgjigjeve mbi mungesën e të dhënave për pagesën e sigurimeve shoqërore nga ish-punëdhënësi.

Trupi gjykues i Kolegjit shqyrtoi pretendimin e subjektit të rivlerësimit për shmangie të qëndrimit të Komisionit, në rastin e saj nga vendimmarrjet e mëparshme, duke vlerësuar se një pretendim i tillë nuk mund të përbëjë *a priori* shkak për ta konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Ky qëndrim është tashmë i konsoliduar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>5</sup>. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet në mënyrë individuale, mbi bazën e rrethanave konkrete faktike dhe zbatimit të ligjit për secilin rast. Përpos këtij arsyetimi, trupi gjykues vlerëson se, është Kolegji i vetmi organ gjyqësor i procesit të rivlerësimit, i cili garanton ruajtjen e trajtimit të barabartë të subjekteve që i janë nënshtruar këtij procesi, qoftë për shkak të ushtrimit të funksioneve gjyqësore, por edhe për shkak të kompozimit të tij. Sa i përket pretendimeve të subjektit lidhur me marrjen e vendimit nga Komisioni në cenim të respektimit të jetës private, trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit nuk i argumenton ato. Nga kontrolli i vendimit dhe i procedurës së ndjekur nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se hetimi administrativ i kryer për subjektin nuk duket se paraqet ndërhyrje në jetën private, familjare apo profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas përcaktimeve të nenit 8 të KEDNj-së<sup>6</sup>. Për rrjedhojë, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit nuk gjenden të bazuara në faktet apo provat e administruara.

11.2. *Subjekti pretendon shkelje të procesit të rregullt ligjor, shoqëruar me shkelje të parimit të sigurisë juridike, të kontradiktorialitetit, proporcionalitetit dhe të ligjshmërisë në procesin e*

<sup>3</sup> “Atanasovski kundër ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë”, nr. 36815/03, § 38, 14 prill 2010; “Domenech Aradilla dhe Rodríguez González kundër Spanjës”, nr. 32667/19 dhe nr. 30807/20.

<sup>4</sup> Subjekti, në shkaqet e ankimit, sa i përket trajtimit të kursimeve të familjes së bashkëshortit, referon vendimin nr. 185, datë 23.07.2019, të Komisionit, që i përket subjektit të rivlerësimit O. Ç., dhe vendimin nr. 327, datë 23.12.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit V. V., si dhe vendimet e Kolegjit nr. 26/2023 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit G. Xh., e nr. 20/2023 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit B. M.

<sup>5</sup> Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 7/2019 (JR); nr. 34/2021 (JR); nr. 8/2022 (JR); nr. 38/2022 (JR); nr. 48/2024 (JR) etj.

<sup>6</sup> (1) Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij. 2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve”.

*vendimmarrjes*, pasi Komisioni, në kundërshtim me parashikimet e nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nuk ka vlerësuar kriterin e pasurisë në përputhje me qëllimin e ligjit, sipas parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit. Sipas subjektit, Komisioni nuk ka kryer një analizë të plotë e objektive të provave të administruara dhe nuk ka garantuar të drejtën e saj për t'u dëgjuar në mënyrë efektive. Seanca dëgjimore ka qenë thjesht një formalitet, të drejtat e subjektit të rivlerësimit janë respektuar vetëm *prima facie*, duke mos përmbushur kështu qëllimin e mbajtjes së saj në drejtim të sqarimit të rrethanave të çështjes dhe analizimit të provave të paraqitura, dëshmuar kjo edhe nga mungesa e debatit, dhe qëndrimi i Komisionit në seancë, duke mos bërë asnjë pyetje, ndërkohë që vendimi ishte i paracaktuar.

11.2.1. Trupi gjykues i Kolegjit, në një vlerësim tërësor të procedurës së ndjekur nga Komisioni, nga shqyrtimi i përmbajtjes së dokumentit *“Rezultatet e hetimit kryesisht për subjektin e rivlerësimit Ornela Rrumbullaku”*, evidenton se, në kontrollin e kryer për secilën pasuri, Komisioni ka evidentuar veprimet konkrete hetimore, të gjitha provat e administruara, dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, duke cituar dhe analizuar në mënyrë të plotë aktet e administruara dhe vlerën e tyre provuese. Në përfundim, nga Komisioni është evidentuar pamjaftueshmëri e konsiderueshme financiare, e cila tejkalon kufijtë e proporcionalitetit dhe cenon besueshmërinë e vlerësimit të kriterit të pasurisë në këtë proces. Po ashtu, seanca dëgjimore nuk mund të vlerësohet se ka qenë formale, për sa kohë subjekti i rivlerësimit u paraqit personalisht, parashtroi shpjegimet e saj lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, ka pasur të drejtën, dhe i është dhënë mundësia të kundërshtojë dhe të shpjegojë të gjitha faktet dhe provat e mbledhura, në kuadër të kalimit të barrës së provës nga Komisioni, si dhe të parashtrojë çdo kërkesë që e ka vlerësuar në interes të mbrojtjes efektive. Nga sa më sipër, nuk evidentohen të dhëna, qoftë edhe në formën e indicieve të relatuara nga vetë subjekti, se vendimi i Komisionit ka qenë i paracaktuar apo i paragjykuar. Mungesa e debatit dhe qëndrimi i Komisionit, duke mos bërë asnjë pyetje, nuk përbëjnë arsye për të vlerësuar një vendimmarrje të tillë. Për rrjedhojë, këto pretendime të subjektit të rivlerësimit nuk gjenden të bazuara në fakte.

11.3. Sipas subjektit të rivlerësimit, *Komisioni ka bërë vlerësim të gabuar të parashikimeve të Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligjit nr. 84/2016*, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting*, ajo ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj, si dhe të gjithë informacionin që njihet dhe kishte mundësi të siguronte. Në vlerësimin dhe interpretimin sistematik e logjik që i bëhet nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, rezulton se asnjë sanksion nuk mund të zbatohet ndaj subjekteve të rivlerësimit, nëse organet verifikuese nuk gjejnë dëshmi pozitive se subjekti ka paraqitur të dhëna të rreme, me qëllim fshehjen e pasurisë. Për sa kohë rezulton se neni 61, pika 1 e ligjit parashikon se: *“Shkarkimi nga detyra i subjektit të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste: 1. Kur rezulton se ka deklaruar me shumë se dyfishi i pasurisë së ligjshme gjatë vlerësimit të pasurisë, përfshirë edhe personat e lidhur me të”*, sipas subjektit, atëherë ky është i vetmi shkak për të cilin mund të merret masa disiplinore e shkarkimit nga detyra, në lidhje me kriterin e kontrollit të pasurisë. Subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje se GjEDNj-ja, në çështjen *“Xhoxhaj kundër Shqipërisë”*, ka interpretuar që, shkarkimi nga detyra, veçanërisht i gjyqtarëve ose prokurorëve me status të përjetshëm në detyrë, është një sanksion disiplinor i rëndë, nëse jo sanksioni disiplinor më i rëndë, që mund të vendoset ndaj një individi. Për këtë arsye, vendosja e një mase të tillë kërkon marrjen në konsideratë të provave të forta që lidhen me etikën, integritetin dhe kompetencën profesionale të individit. Ndërsa, në çështjen *“Sevdari kundër Shqipërisë”*, GjEDNj-ja ka vendosur disa standarde sa i përket proporcionalitetit, të cilat, në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, janë të aplikueshme edhe në rastin e saj.

11.3.1. Trupi gjykues i Kolegjit, për sa trajtuar gjerësisht në jurisprudencën e tij<sup>7</sup>, vlerëson se tashmë është konsoliduar qëndrimi se, secili prej paragrafëve të nenit D të Aneksit të Kushtetutës parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, të lidhur me rrethanat, sipas të cilave, prezumohet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit. Secila nga këto rrethana është projektuar në përcaktimet e masave disiplinore, sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke e materializuar sanksionimin kushtetues me përcaktimin konkret të shkeljes. Më konkretisht, neni D i Aneksit të Kushtetutës është zbërthyer në parashikimet e pikave 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, të cilat pasqyrojnë dy raste të veçuara nga njëri-tjetri, ku njëri lidhet me dyfishin e pasurisë së ligjshme, dhe tjetri me pamjaftueshmërinë e deklaramit të pasurisë, duke pasjellë masa disiplinore të veçuara nga njëra-tjetra. Sa i takon koherencës së vendimmarrjes në raport me qëndrimet e mbajtura nga GjEDNj-ja, Kolegji thekson se vendimmarrja e Komisionit i nënshtrohet shqyrtimit në Kolegj, çka adreson rëndësinë e nënvizuar nga GjEDNj-ja për krijimin e mekanizmave që mund të sigurojnë koherencën e praktikës dhe njësimin e jurisprudencës, përfshirë atë të GjEDNj-së.

11.4. Trupi gjykues, referuar sa më sipër, analizoi edhe kërkesën e subjektit të rivlerësimit lidhur me formën e gjykimit të çështjes, dhe administrimin e akteve shkresore bashkëlidhur ankimit në cilësinë e provës, si dhe parashtrimeve të paraqitura në Kolegj. Nga shqyrtimi dhe analizimi i tyre, trupi gjykues vlerësoi se aktet bashkëlidhur ankimit nuk plotësojnë kërkesat e nenit 47 të ligjit nr. 49/2012<sup>8</sup>, i ndryshuar, pasi subjekti nuk provoi se, pa fajin e saj, nuk ka mundur t'i paraqesë këto akte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Komision, në afatet e parashikuara në këtë ligj. Lidhur me aktet bashkëlidhur parashtrimeve, trupi gjykues sjell në vëmendje kërkesat e nenit 49 të ligjit nr. 49/2012<sup>9</sup>, i cili nuk parashikon mundësinë e subjekteve për paraqitjen e akteve të reja, por vetëm parashtrime me shkrim brenda afatit të përcaktuar në ligj. Në kuadër të analizës së mësipërme, duke mbajtur në konsideratë edhe parashikimet e nenit 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues çmoi se marrja e tyre vlerësohet e panevojshme, pasi nuk kanë ndikim në vendimmarrje, e, për rrjedhojë, nuk i mori ato në cilësinë e provës.

11.4.1. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues nuk evidentoi situata ligjore dhe procedurale të parashikuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, të cilat do të sillnin nevojën e shqyrtimit të çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve, duke vendosur të vijojë me shqyrtimin e çështjes në ngarkim të subjektit të rivlerësimit në dhomë këshillimi, mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49, paragrafi 1 i ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

## **B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit për kriterin e vlerësimit të pasurisë**

*B/1 Për pasurinë “aksione” në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA*

12. Komisioni, lidhur me këtë pasuri, ka arritur në përfundimin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të rezultojnë me pamundësi financiare në krijimin e shumës për blerjen e kuotave në këtë shoqëri, në vlerën totale (-) 3.300.000 lekë, pasi personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje kursimesh

<sup>7</sup> Shih, ndër të tjera, vendimet nr. 12/2018 (JR); nr. 10/2019 (JR); nr. 21/2020 (JR); nr. 19/2021 (JR); nr. 34/2021 (JR) dhe nr. 12/2022 (JR), të Kolegjit.

<sup>8</sup> Ligji nr. 49/2012, në nenin 47, parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”.

<sup>9</sup> Ligji nr. 49/2012, në nenin 49, pika 2, parashikon: “[...] Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim”.

*cash* në fund të vitit 2013, të cilat mund të ishin krijuar nga të ardhurat e tij përpara fillimit të bashkëjetesës.

12.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë konkluzion të Komisionit, duke ngritur paraprakisht në shkaqet e ankimit pretendimin se detyrimi për deklarimin e pasurive dhe për ndryshimin e tyre për personin e lidhur të subjektit, bashkëjetuesin, lindi vetëm në vitin 2014, pasi me ligjin nr. 45/2014 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, ‘Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë’” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”), i ndryshuar, në rrethin e personave të lidhur, në nenin 21 të tij, u shtua edhe nocioni i “bashkëjetuesit/es”. Nisur nga ky këndvështrim, nuk rezulton të jenë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit të ardhurat e bashkëjetuesit, likuiditetet, ndryshimet e tyre apo mbartja e gjendjes *cash* etj., në deklaratimet e kryera prej saj në periudhën 2011 – 2013, në të cilën Komisioni ka konstatuar edhe balancat negative, që lidhen me të ardhurat e personit të lidhur. Përveç mungesës së detyrimit ligjor për deklarim, sipas subjektit, Komisioni duhet të kishte mbajtur në konsideratë edhe faktin se: (a) Të gjitha pasuritë e deklaruara nga bashkëjetuesi pas vitit 2014 janë në pronësi të plotë të tij, të përcaktuara si të tilla, edhe nga kontrata për përcaktimin e regjimit pasuror martesor, e datës 22.05.2017. (b) Të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, në asnjë rast nuk kanë shërbyer si burim për krijimin e tyre, madje, subjekti, në pjesën më të madhe të veprimeve të kryera nga bashkëjetuesi, nuk ka shfaqur dijeni për to, përveçse në vitin 2014, kur personi i lidhur duhet të deklaronte gjendjen e interesave pasurorë. (c) Subjekti i rivlerësimit nuk ka kryer veprime apo transaksione, që kanë lidhje me blerjen e aksioneve në pronësi të personit të lidhur. (d) Nuk u vërtetua që, gjatë viteve 2012 dhe 2013, vite në të cilat subjekti nuk ka deklaruar pasuri të bashkëjetuesit, ai të ketë pasur në pronësi pasuri të ndryshme nga ato të deklaruara në deklaratën periodike të vitit 2014 dhe ato të viteve në vijim.

12.1.1. Sipas subjektit, nga ana substanciale, i vetmi interes privat me personin e lidhur, sipas parashikimit të nenit 3, të ligjit nr. 85/2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, i ndryshuar, ka qenë fakti që subjekti ka banuar në apartamentin në bashkëpronësi me bashkëjetuesin, fakt ky i deklaruar prej saj në deklaratat periodike të viteve 2012 dhe 2013. Ndërsa, nga pikëpamja formale, mungesa e deklarimeve të subjektit në këto vite, nuk ka pasur si qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo interesi privat të subjektit të rivlerësimit dhe as të bashkëjetuesit të saj, e, në këto rrethana, nuk duhet konsideruar si shkak për penalizimin e saj. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti dhe personi i lidhur kanë paraqitur dokumentacionin justifikues ligjor për të gjitha pasuritë e deklaruara dhe të disponueshme në datën e plotësimit të kësaj deklarate, përfshirë transaksionet bankare të gjeneruara nga bankat e nivelit të dytë. Nisur nga kjo premisë, subjekti i rivlerësimit pretendon se, të gjitha të ardhurat e bashkëjetuesit deri në vitin 2014 duhet të trajtohen nga Kolegji, sipas metodës financiare kumulative, pa u ndalur dhe pa e fragmentuar analizën vjetore të krijimit të pasurive të tij.

12.1.2. Për sa më sipër, subjekti kërkon që të rishikohet analiza financiare për periudhën kur personi i lidhur ka investuar në aksionet e shoqërisë “{\*\*\*}” (në vijim “{\*\*\*}” ShA), si dhe të merren në konsideratë si burim i ligjshëm të ardhurat e personit të lidhur, bashkëjetuesit, konkretisht: (i) shuma 10.000 euro dhënë nga R. Z., kaluar në llogarinë bankare të bashkëjetuesit, më datë 27.12.2010, dhe (ii) të ardhurat e krijuara nga aktiviteti bujqësor i familjes së bashkëjetuesit.

12.2. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve të subjektit të rivlerësimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, paraprakisht vlerëson të analizojë lidhur me pretendimin e subjektit që nga Komisioni duhej vlerësuar se subjekti nuk ka pasur detyrim ligjor për

*deklarimin e pasurive të bashkëjetuesit të saj deri në vitin 2014 dhe, nisur nga kjo premisë, të ardhurat e tij duhen trajtuar sipas metodës financiare kumulative.*

12.2.1. Duke mbajtur në konsideratë parashikimet e nenit 21 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, dispozitë e cila ka ndryshuar me miratimin e ligjit nr. 45/2014, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003”, trupi gjykues vëren se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit është përfshirë në rrethin e familjarëve deklarues, në cilësinë e bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, në vitin 2014, me miratimin e këtyre ndryshimeve ligjore. Në këto rrethana, trupi gjykues vendosi kryerjen e analizës financiare kumulative për periudhën 2001 – 31.12.2013, duke vlerësuar fillimisht ligjshmërinë e secilës së ardhur të pretenduar si burim për blerjen e aksioneve, të realizuara nga personi i lidhur përpara vitit 2014.

12.3. Sa i përket pretendimit të ngritur nga subjekti në ankim që, *për vlerësimin e këtij kriteri, të mbahet në konsideratë edhe lidhja e kontratës për përcaktimin e regjimit pasuror martesor<sup>10</sup>, e datës 22.05.2017*, trupi gjykues konstaton se, *së pari*, zotërimi i aksioneve në shoqërinë tregtare objekt shqyrtimi, të krijuara gjatë bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, është deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting*, plotësuar më 26.01.2017, e për rrjedhojë, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenin 32 të ligjit nr. 84/2016, këto aksione bëhen objekt kontrolli në këtë proces. Barra e provës zhvendoset te subjekti i rivlerësimit, pra i përket këtij të fundit detyrimi për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe pretendimet e saj, duke paraqitur provat e faktet e nevojshme për këtë qëllim. *Së dyti*, kontrata për përcaktimin e regjimit pasuror martesor, e cila daton pas plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, vlerësohet pa ndikim në drejtim të kontrollit të kriterit të pasurisë e vërtetësisë së deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për efekt të këtij procesi.

13. Në vijim të sa sipër, nga shqyrtimi i akteve të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit dhe pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim e parashtrime, lidhur me këtë shkak ankimor, trupi gjykues i Kolegjit konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

13.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, rubrika “*Deklarimi i pasurive*”, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, bashkëjetuesi, ka deklaruar: “*Aksione në ‘{\*\*\*}’ ShA, person juridik i regjistruar më 15.09.2014, me NIPT {\*\*\*}*”. Burimi i krijimit: “*Të ardhurat e mia para bashkëjetesës*”. Shoqëria është me status “*pezulluar*” dhe nuk ka kryer asnjëherë aktivitet tregtar. Mungojnë aktet nënligjore për kryerjen e veprimtarisë. Shoqëria do të çregjistrohet. Vlera e deklaruar “10.000.000 lekë”. Pjesa takuese “33%”. Në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike*”, janë deklaruar këto të ardhura të realizuara përpara datës së krijimit të kësaj shoqërie:

- *Të ardhura nga personi fizik “A. M.”, me NIPT {\*\*\*}, për vitin 2010. Të ardhurat janë pas tatimit. Kjo e dhënë nuk vërtetohet nga DRT-ja, për shkak të kohës mbi 5 vjet, por provohet me bilancin e subjektit dhe vërtetim nga Bashkia Tiranë. Shuma “274.692 lekë”.*

- *Të ardhura neto nga personi fizik “A. M.”, me NIPT {\*\*\*}; për vitin 2010, nuk kam qenë subjekt i pagesës së dividendit ose tatim fitimit. Ky NIPT është çregjistruar më datë 13.05.2009. Shuma “4.214.921 lekë”.*

- *Paga neto nga {\*\*\*}, (nuk disponoj vërtetim, pasi nuk jam pajisur me vërtetim nga ky institucion, edhe pse kam bërë kërkesë). Ky informacion merret pranë këtij institucioni, me adresë “{\*\*\*}”, sheshi “{\*\*\*}”, Tiranë. Vlera “105.000 lekë”.*

<sup>10</sup> Sipas përcaktimeve të nenit 115 e në vijim të Kodit të Familjes.

- Pagë nga {\*\*\*} për pozicionin drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, për periudhën shtator 2006 – shtator 2007. Shuma “721.168 lekë”.
- Pagë neto si avokat pranë zyrës ligjore “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, në rrugën “{\*\*\*}”, në periudhën prill – shtator 2009. Shuma “770.371 lekë”.
- Të ardhura neto nga ish-komuna “{\*\*\*}” si anëtar i Këshillit të Komunës, në periudhën nga 28.06.2011 deri më 30.10.2014, (aktualisht njësi administrative, pjesë e Bashkisë Lushnjë). Ndaj ish-komunës, nuk kam detyrime për tokën bujqësore, pasi janë likuiduar të gjitha detyrimet. Shuma “277.884 lekë”.
- Të ardhura neto nga {\*\*\*}, si kryetar i Dhomës Kombëtare të Zgjidhjes së Konflikeve, në periudhën 2010 – 2016. Shuma “772.000 lekë”.
- Të ardhura neto nga pozicioni administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 22.10.2009 deri më 17.03.2010. Shuma “307.247 lekë”.
- Parapagim nga K. L., nga “Kontratë shërbimi” nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 30.04.2013, noter A. R. Për pjesën tjetër të detyrimit prej 30.000 eurosh, po zhvillohet proces gjyqësor. Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. {\*\*\*}, datë 26.04.2016, ka vendosur detyrimin që K. L. të paguajë 30.000 euro. Vendimi i ankimuar nuk paraqitet me vulë pa marrë formë të prerë (dosja është në Gjykatën e Apelit Tiranë, në pritje për gjykim). Në përfundim të gjykimit, do të vlerësohet pagesa e detyrimeve tatimore (debitori ka mundësi alternative të pagesës në natyrë, në varësi të pagesës, llogaritet tatimi). Shuma “10.000 euro”.
- Të ardhura neto, në total, nga {\*\*\*}, për periudhën tetor 2001 – dhjetor 2001, vitet 2002 – 2004, dhe janar – shkurt 2005. Shuma “732.215 lekë”.

13.2. Në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur për vitin 2014, A. M., në cilësinë e personit të lidhur, bashkëjetuesit të subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar zotërimin e aksioneve sa më sipër, me burim krijimi “të ardhurat e mia”.

13.3. Në deklaratën e interesave privatë 2015, personi i lidhur me subjektin deklaroi: “Tërheqje si parapagim rroge gjatë vitit 2015 nga ‘{\*\*\*}’ ShA, ku jam administrator i shoqërisë. Shuma “960.000 lekë”.

13.4. Referuar informacionit të përcjellë nga Qendra Kombëtare e Biznesit (në vijim “QKB”)<sup>11</sup>, rezultoi që kjo shoqëri të jetë regjistruar më datë 15.09.2014, me NUIS {\*\*\*}, me kapital 10.000.000 lekë, vlerë kapitali të shlyer 3.324.304 lekë, me administrator A. M. (administrim me dy nivele),<sup>12</sup> dhe objekt kryesor veprimtarie “zhvillimin e aktiviteteve të ndërtimit, operimit, menaxhimit të Institutit Privat të Vuajtjes së Dënimit në territorin e Republikës së Shqipërisë, konform legjislacionit shqiptar në fuqi, dhe me lejet e autorizimet e lëshuara nga autoritetet shtetërore”. Personi i lidhur me subjektin, A. M., figuron të ketë qenë ortak, zotërues i 33%<sup>13</sup> të kuotave të kapitalit të shoqërisë. Shlyerja e pjesës së kapitalit nga ana e A. M., provohet me urdhërshkrimin e brendshëm të shumës 3.300.000 lekë, nga llogaria e tij, në favor të shoqërisë në Credins Bank ShA, më datë 29.07.2014, me përshkrimin: “derdhje kapitali nga ortaku”, të depozituar nga bashkëjetuesi i subjektit në QKB.

<sup>11</sup> Shkresa e QKB-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2023, bashkëlidhur së cilës ka përcjellë ekstrakt historik të regjistrimit tregtar për të dhënat e shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, dhe shkresa e QKB-së nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2021.

<sup>12</sup> Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës: (i) A. M., (ii) A. S., (iii) Th. K., me pjesëmarrje, përkatësisht 33%, 34% dhe 33%. Ekspert kontabël: “{\*\*\*}” ShPK.

<sup>13</sup> Së bashku me ortakët e tjerë, A. S. me 34% të kuotave, dhe Th. K. me 33% të kuotave.

13.5. Në analizë të pasqyrës së pozicionit financiar për vitet 2014 – 2015, përcjellë nga QKB-ja, shoqëria rezultoi me balancë 10,000,000 lekë në zërin “Aktive afatshkurtra”, nënçeri “Banka”, dhe balancë të njëjtë të zërit “Detyrimet totale”, nënçeri “Kapital i nënshkruar”, si për vitin 2014, ashtu edhe për vitin 2015. Nuk evidentohet që shoqëria të ketë kryer aktivitet ekonomik e të ketë realizuar qarkullim / të ardhura apo fitim gjatë periudhës 15.09.2014 – 31.12.2015.

13.6. Sipas lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit tregtar “{\*\*\*}” ShA, përcjellë nga Credins Bank ShA<sup>14</sup>, rezultoi që më datë 16.07.2014, llogaria rrjedhëse e tij me nr. {\*\*\*} të jetë kredituar me 3.400.129,6 lekë<sup>15</sup>, vlerë e transferuar me urdhërxhirim, me përshkrimin: “*Instituti Privat Vuajtjes D, kalim kapitali fillestar për themelim, A. M.*”. Më datë 29.07.2014, e njëjta llogari është kredituar me 3.300.000 lekë, me përshkrimin: “*M. A. - derdhje kapitali nga ortakut*” dhe, më datë 01.08.2014, me *transfertë nga banka të tjera*, kjo llogari është kredituar me 3.300.000 lekë, me përshkrimin: “*Th. I. K. trn. no. {\*\*\*}, derdhje e kuotave të kapitalit themelues të {\*\*\*} Sarandë, sipas statutit dhe aktit të themelimit*”. Në total, vlerat e derdhura në këtë llogari për kapital themeltar të shoqërisë nga ortakët kanë qenë 10.000.129,60 lekë. Në analizë të transaksioneve të kryera përmes kësaj llogarie, konstatohet që vlerat e derdhura për kapital themeltar nga ortakët të jenë transferuar në llogarinë tjetër rrjedhëse të shoqërisë me nr. {\*\*\*}.

13.7. Nisur nga transaksionet e kryera në vijim në të njëjtën llogari, evidentohet se, nga data 02.03.2015 deri më 04.09.2015, A. M. ka tërhequr *cash*, në total 960.000 lekë<sup>16</sup>. Shuma prej 1.270.000 lekësh e mbetur në këtë llogari pas tërheqjeve është transferuar më 21.07.2016, me përshkrimin: “*përfituesi G. M., trn. no. {\*\*\*}, dhënie huaje*”. Përveç sa sipër, konstatohet gjithashtu se, më datë 11.11.2014, nga llogaria nr. {\*\*\*} është transferuar shuma prej 1.000.000 lekësh, me përshkrimin: “*{\*\*\*} ShA, për kapital themeltar, A. M.* Më datë 19.11.2014, A. M. ka tërhequr nga kjo llogari vlerën 1.000.000 lekë në *cash* dhe ka riderdhur në të po këtë vlerë më datë 19.12.2014.

13.8. Në përgjigje të kërkesës së Komisionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim “DPT”), me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2023, informon se, sipas të dhënave në sistemin tatimor c@ts, nuk ka të ardhura të deklaruara nga aktiviteti i shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, për vitet 2014, 2015 dhe 2016. Ky subjekt tregtar ka detyrime të papaguara në vlerën 140.000 lekë<sup>17</sup> dhe rezultoi me status “i pezulluar” nga data 27.09.2016, pa afat. Gjithashtu, nga kjo drejtori<sup>18</sup> konfirmohet se personi i lidhur me subjektin, A. M., figuron pagëmarrës në këtë shoqëri si administrator, me pagë bruto/neto “0 lekë”, për periudhën 09/2012 – 09/2016.

13.9. Në shpjegimet e dhëna në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të Komisionit, lidhur me burimin e krijimit të shumës 3.300.000 lekë për blerjen e aksioneve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në vitin 2014,

<sup>14</sup> Shkresa e lëshuar nga Credins Bank ShA, me nr. prot. {\*\*\*}, datë 09.01.2024.

<sup>15</sup> Transferuar në llogarinë e sipërcituar ({\*\*\*}), shuma 24,304 euro, e konvertuar me 139.9 ALL/EUR, në total 3.400.129.60 lekë, nga llogaria me numër {\*\*\*}, në monedhën euro, e po kësaj shoqërie, “{\*\*\*}” ShA.

<sup>16</sup> Pjesa tjetër e kapitalit të derdhur nga aksionaret e tjerë - shuma e mbajtur, e bllokuar për kapital, prej 6.700.129 lekësh, është transferuar më 01.07.2015, me përshkrimin “‘{\*\*\*}’, kalim kapitali themeltar”, në llogarinë rrjedhëse “{\*\*\*}” ({\*\*\*}), nga të cilat, i është transferuar brenda ditës vlera 1.400.000 lekë shtetasit A. S., me përshkrimin “Kalim në llogari të ortakut, {\*\*\*}” dhe, më datë 03.07.2015, shuma 3.300.000 lekë i transferohet në llogari shtetasit Th. K., me përshkrimin: “Kalim në llogari të ortakut ‘{\*\*\*}’”. Ndërsa, nga balanca e mbetur, vlera prej 1.270.000 lekësh i transferohet më datë 21.07.2016, shtetasit G. M. (vëllait të bashkëjetuesit) me përshkrimin “dhënie huaje”.

<sup>17</sup> Në datën e lëshimit të shkresës nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

<sup>18</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.03.2021.

subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, si burim kanë shërbyer të ardhurat e personit të lidhur ndër vite, si avokat dhe konsulent ligjor për individë dhe shoqëri të ndryshme, si dhe të ardhurat e përbashkëta të familjes së tij bujqësore, duke specifikuar:

(i) 10.000 euro (konvertuar në shumën 1.400.000 lekë) nga zoti K. L. (për këtë pagesë, është dorëzuar për procesin e rivlerësimit “deklaratë noteriale”, lëshuar nga z. K. L.).

(ii) 10.000 euro (apo 1.400.000 lekë) nga zoti R. Z. (vërtetuar me transfertë bankare, si dhe nga shtetasi R. Z., bashkëlidhur kësaj përgjigjeje).

(iii) 600.000 lekë të ardhura nga avokatia për vitin 2011, ushtruar me NIPT {\*\*\*}. Bashkëlidhur kopje ekstrakti nga QKB-ja, ku rezulton “aktiv” për vitin 2011. Për vitin ushtrimor 2011, janë paguar detyrimet ndaj administratës tatimore vendore.

(iv) Lidhur me të ardhurat e bashkëjetuesit A. M., sqaroj se ai dhe familja e tij janë përfitues të tokës bujqësore, sipas ligjit nr. 7501/1991. “Për tokën bujqësore”, dhe kanë pasur administrim të përbashkët të të ardhurave [...]. Kontributi në vite dhe të ardhurat janë të ndryshueshme, por, në mënyrë konstante, bashkëjetuesi A. M. ka kontribuuar dhe ka kryer administrim bashkë me babanë, U., i cili ka ndërruar jetë në janar 2013 dhe, më pas, i ka administruar me vëllanë, G. M.

13.10. Përveç sa më lart, me përgjigjet e këtij pyetësi, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar për Komisionin se, me personin e lidhur, përpara lidhjes së martesës ligjore, ka nënshkruar më datë 22.05.2017 “Kontratë për përcaktimin e regjimit pasuror martesor”, ndaj, çdo pasuri që ai ka krijuar përpara martesë është e tija dhe lidhet vetëm me marrëdhëniet që ai ka me familjen e tij, dhe se subjekti nuk ka të drejta ose detyrime mbi to. Këto pasuri janë krijuar me burim të ardhurat e tij personale dhe ato të familjes së tij dhe ky saktësim, sipas subjektit, vlen për të gjitha pasuritë e krijuara nga bashkëjetuesi.

13.11. Në vijim të sa sipër, Komisioni ka analizuar të ardhurat e deklaruara si burim krijimi të aksioneve në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, ndërsa, sa i përket kontratës për përcaktimin e regjimit pasuror martesor, të datës 22.05.2017, ka konstatuar se ajo është nënshkruar pak kohë para se të lidhej martesa e tyre ligjore, por gati tri vite pas krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi dhe ndryshimeve të tjera në shoqërinë tregtare në fjalë.

*Lidhur me burimet e krijimit të aksioneve “{\*\*\*}” ShA*

14. Për shumën 10.000 euro, deklaruar si e marrë paradhënie nga shtetasi K. L., trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, Komisioni, ndonëse fillimisht nuk e ka përfshirë këtë shumë në analizën financiare, me arsyetimin se nuk përmbushte kriteret e burimit të ligjshëm, sipas nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pas vlerësimit të shpjegimeve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në përgjigje të rezultateve të hetimit, i ka çmuar ato bindëse dhe të mbështetura në prova. Për rrjedhojë, kjo shumë është përfshirë në analizën financiare të vitit 2013, të rishikuar nga Komisioni, sipas arsyetimit të pasqyruar në vendim. Për këtë arsye, ajo nuk përbën shkak ankimi dhe, si e tillë, nuk është objekt shqyrtimi në kuadër të pretendimeve të subjektit.
15. Lidhur me burimin e ligjshëm të krijimit të shumës 10.000 euro, të transferuar në llogarinë e bashkëjetuesit nga R. Z.

15.1. Komisioni, edhe pse vlerësoi se subjekti i rivlerësimit arriti të provojë se ky shtetas ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të dhënë shumën 10.000 euro, çmoi se ajo nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për derdhjen e kapitalit në shoqëri nga bashkëjetuesi, pasi vlerësoi

se qëllimi i transferimit saj është deklaruar nga subjekti vetëm gjatë procesit të rivlerësimit. Në deklaratat noteriale të z. R. Z., nuk përcaktohet që kjo vlerë është dhuruar prej tij, por se ajo është dhënë si shpërblim për shërbimet e konsulencës, kryer në favor të tij nga A. M., ndërkohë që nuk u arrit të provohej shlyerja e detyrimeve tatimore për të.

15.2. Sipas pretendimeve të subjektit në ankim, kjo shumë identifikohet saktë që në vitin 2010, nëpërmjet transfertës bankare pranë një banke të nivelit të dytë, provë e cila është dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit përpara se asaj t'i ngarkohej barra e provës, në një fazë të hetimit administrativ kur nuk ishte njohur ende me rezultatin e analizës financiare. Për subjektin, Komisioni, në mënyrë të gabuar ka konstatuar se nuk janë dhënë shpjegime bindëse për transfertën prej 10.000 eurosh në llogarinë e personit të lidhur, ndërkohë që nga vlerësimi harmonik i deklaratës së z. R. Z. dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, del qartë që kjo shumë është shpërblim, në kuptimin e mirënjohjes dhe marrëdhënies ndër vite mes tyre. Transferta është kryer shumë kohë para nisjes së procesit të *vetting*-ut dhe, fakti që është realizuar përmes rrugëve bankare, tregon se ajo është reale. Gjithashtu, rezulton e provuar se, më pas, A. M. ka pasur marrëdhënie punësimi me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën R. Z. është ortak i vetëm dhe marrëdhënia mes tyre është e konsoliduar në shumë vite, përpara transfertës bankare dhe më pas, dëshmuar kjo në Komision, dhe nga udhëtimet e shpeshta të tyre ndër vite, për qëllime të sipërmarrjes apo për vizita shëndetësore të R. Z. Transferimi i shumës 10.000 euro në favor të A. M. nuk lidhet drejtpërdrejt me një pagesë, si pasojë e një marrëdhënie punësimi ose të një natyre tjetër që passjell detyrimin për pagesë detyrimesh tatimore, çka do ta bënte atë të ardhur të panjohur në këtë proces. Po ashtu, thekson subjekti, pavarësisht se kjo e ardhur nuk është pasqyruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, një harresë e tillë, nëse vlerësohet se duhet të ishte deklaruar, atëherë të trajtohet nga ana e Kolegjit në kuadrin e një pasaktësie, për aq kohë sa evidentohet qartazi si transaksion i gjurmueshëm që në vitin 2010, për të cilin subjekti nuk ka asnjë kontribut apo përfitim konkret dhe që, në momentin e plotësimit të deklaratës së pasurisë *vetting*, nuk disponohej më. Për sa i përket burimit të ligjshëm të krijimit të kësaj shume nga R. Z., subjekti pretendon se është provuar plotësisht fakti që ato vijnë nga qiraja e përfituar nga një institucion bankar, me marrëveshje të formalizuar (dokument i noterizuar), shumë vite para nisjes së procesit të rivlerësimit. Për sa më sipër, subjekti kërkon që vlera 10.000 euro, e transferuar në llogarinë e personit të lidhur nga R. Z. më datë 27.12.2010, duhet të konsiderohet e ligjshme, pasi përmbush kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

15.3. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, si dhe shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit, për këtë çështje vlerësoi si më poshtë:

15.3.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur me subjektin, A. M., si burim për krijimin e aksioneve në “{\*\*\*}” ShA, ka deklaruar “*të ardhurat e mia para bashkëjetesës*”. Në rubrikën “*Angazhime dhe veprimtari private dhe/ose publike*”, të së njëjtës deklaratë, personi i lidhur ka identifikuar të gjitha burimet e krijimit ndër vite, që datojnë para dhe pas dhënies së shumës 10.000 euro nga R. Z., më datë 27.12.2010. Në këtë rubrikë, personi i lidhur nuk ka deklaruar si të ardhur nga R. Z. shumën prej 10.000 eurosh, si dhe nuk ka deklaruar të ardhura nga shërbimet e konsulencës, punësimi apo shpërblime nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, sikurse pretendon se ka qenë i punësuar më pas pranë kësaj shoqërie.

15.3.2. Në deklaratën e interesave privatë 2014, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar për herë të parë aksionet në “{\*\*\*}” Sarandë ShA, me burim “*të ardhurat e mia*”, pa i specifikuar ato. Në

deklaratat periodike të personit të lidhur, nuk janë deklaruar të ardhura nga punësimi apo shërbimet e konsulencës nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK.

15.3.3. Me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka përcjellë në Komision deklaratë të thjeshtë, datë 20.07.2023, të shtetasit R. Z., ortak i vetëm dhe administrator i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilën deklaron se pagesa me vlerë 10.000 euro është kryer si shpërblim për shërbimet e konsulencës së vazhdueshme, të kryera nga A. M., duke filluar nga viti 2006 e në vijim. Më pas, ai deklaron se A.M. ka qenë i punësuar edhe në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK.

15.3.4. Nga analizimi i lëvizjeve të llogarive të personit të lidhur, përcjellë në Komision nga Tirana Bank ShA, ka rezultuar se, më datë 27.12.2010, në llogarinë e tij është kryer transfertë hyrëse nga shtetasi R. Z., në vlerën 10.000 euro, me përshkrimin “*likuidim detyrimi*”. Kjo vlerë rezulton të jetë tërhequr në të njëjtën ditë nga personi i lidhur me subjektin, A. M.

15.3.5. Gjithashtu, Instituti i Sigurimeve Shoqërore (në vijim “ISSh”), me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.06.2024, ka bërë me dije Komisionin se: “*Për subjektin ‘{\*\*\*}’ ShPK, për periudhën 2006 – 2012, u kontrollua dosja me nr. {\*\*\*} dhe emri ‘A. M.’ nuk figuron në listëpagesat që administrojmë (deri tani)*”, duke mos konfirmuar kështu të ardhura të personit të lidhur me subjektin, nga paga prej punësimit të pretenduar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nga viti 2006 deri në 2016.

15.3.6. Sa më sipër, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës, pasi vlerësoi se nuk u provua burimi i ligjshëm i shumës 10.000 euro, të transferuar në llogarinë e personit të lidhur pranë Tirana Bank ShA, dhe se subjekti nuk arriti të provojë shlyerjen e detyrimeve tatimore për këtë shumë. Ndërkohë, nuk rezulton që subjekti dhe/ose bashkëjetuesi të kenë deklaruar kursime *cash* në deklaratën e vitit 2012, kur bashkëjetuesi i lindi detyrimi për deklarim pasurie. Për këtë arsye, Komisioni ka vlerësuar se shuma e kaluar në llogarinë e z. A. M. nga R. Z. në vitin 2010 nuk mund të jetë përdorur në vitin 2013 prej tij, duke mos e përfshirë kështu vlerën 10.000 euro si burim krijimi për kapitalin e derdhur në shoqëri në analizën financiare të kryer për këtë qëllim. Me të njëjtin arsyetim, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të ardhurat me vlerë 960.000 lekë, që personi i lidhur me subjektin ka përfituar si parapagim nga kjo shoqëri, për sa kohë nga hetimi u provua se këto të ardhura nuk janë deklaruar në organet tatimore si pagë për punëmarrësin A. M., dhe për to nuk janë shlyer as detyrimet përkatëse.

15.3.7. Subjekti i rivlerësimit, si në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ashtu edhe gjatë hetimit administrativ, ka shpjeguar se shuma prej 10.000 eurosh është transferuar nga shtetasi R. Z. për angazhimin serioz dhe të vlefshëm gjatë bashkëpunimit me personin e lidhur me të. Kjo shumë është dhuruar prej tij në prag të fillimit të bashkëjetesës dhe blerjes së apartamentit në vitin 2011. Në funksion të prapësimeve, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur: (i) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 19.08.2024, e z. R. Z., në të cilën ai deklaron se i ka dhënë personit të lidhur me subjektin shumën prej 10.000 eurosh, më datë 27.12.2010, për shkak të konsulencave të dhëna në periudha të ndryshme lidhur me çështje të veprimtarisë sipërmarrëse dhe personale, si dhe bashkëlidhur saj ka paraqitur: (ii) kontratën e qirasë, datë 01.10.2007, me palë Credins Bank ShA, në cilësinë e qiradhënësit, dhe R. Z. në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira të pasurisë së paluajtshme me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, kundrejt vlerës 5.000 euro/muaj, të ndodhur në zonën e ish-Bllokut, Tiranë, për një afat 10-vjeçar, me anë të së cilës provon mundësinë financiare të tij për të dhënë këtë shumë.

15.3.8. Në analizë të akteve të sipërcituara, trupi gjykues i Kolegjit konstaton se, në deklaratimet e tij, R. Z. është shprehur që, për shkak të konsulencave dhe këshillimit ligjor me z. A. M., të cilat kanë filluar nga viti 2006 e në vijim, shuma prej 10.000 eurosh ka qenë një shpërblim, dhe se personi i lidhur me subjektin ka qenë edhe i punësuar pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në të cilin ai është ortak dhe administrator i vetëm. Nga hetimi, nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor *marrëdhënia e punësimit/shërbimit, shpërblimit apo konsulencës* me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK apo me z. R. Z., në secilin nga variantet e pretenduara nga subjekti, duke mbetur kështu në nivel deklarativ shpjegimet e saj. Në këto rrethana, trupi gjykues e çmon të drejtë vlerësimin e Komisionit se nuk identifikohet qartë arsyeja e transferimit të shumës 10.000 euro, nga R. Z. drejt personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit.

15.3.9. Sipas pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, kjo e ardhur nuk është deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, pasi nuk ka qenë e disponueshme në momentin e plotësimit të kësaj deklarate, por ka shërbyer si burim për krijimin e aksioneve në vitin 2014, ndërkohë që, nga aktet rezulton se nga personi i lidhur me subjektin janë deklaruar në këtë deklaratë, edhe të ardhura të tjera, të cilat nuk kanë qenë të disponueshme në momentin e plotësimit të saj. Për më tepër, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron, pasi në deklaratën e pasurisë *vetting*, “*Shtojca 2 - Deklaratë e pasurisë e personit të lidhur*”, përcaktohet detyrimin për deklarimin e të gjitha të ardhurave nga paga, dhe jo vetëm, duke filluar që nga momenti i fillimit të detyrës deri ditën e deklarimit.

15.3.10. Sa i përket pretendimit të subjektit të rivlerësimit se, nëse vlerësohet nga ana e Kolegjit që vlera 10,000 euro duhet të ishte deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, dhe se një harresë e tillë duhet të trajtohet në kuadrin e një pasaktësie tërësisht të paqëllimshme, trupi gjykues vlerëson se, tashmë Kolegji ka një jurisprudencë të konsoliduar mbi pasaktësitë në deklarime dhe mënyrën se si ato interpretohen në analizën e përgjithshme të kriterit të vlerësimit të pasurisë. Megjithatë, sikurse konstatohet edhe nga trajtimi që Komisioni i ka bërë këtij kriteri, vlerësimi negativ dhe aplikimi i masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit mbi bazën e kontrollit të pasurisë, nuk rezulton të jetë derivat vetëm i pasaktësive në deklarime, sikurse ajo pretendon, por lidhet me mungesën e burimeve financiare të ligjshme, të konstatuara për krijimin e pasurive të deklaruara.

Megjithëse gjatë hetimit administrativ u provua mundësia financiare e z. R. Z. për të krijuar vlerën 10.000 euro, të transferuar në llogarinë e z. A. M. në vitin 2010, në rrethana të tilla që: (i) marrëdhënia e pretenduar e punësimit të personit të lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK nuk rezultoi e provuar në asnjë formë, si dhe nuk ka lënë gjurmë në deklaratën e pasurisë *vetting*; (ii) nga organet tatimore dhe sigurimet shoqërore, nuk u dokumentua që personi i lidhur me subjektin të ketë qenë i punësuar apo të ketë realizuar të ardhura nga kjo shoqëri; (iii) tërheqja e kësaj shume në bankë nga personi i lidhur me subjektin, daton rreth tri vite para se të krijohej shoqëria “{\*\*\*}” ShA, si dhe (iv) në kushtet e mungesës së elementeve të tjera mbi besueshmërinë e qëllimit të marrjes së kësaj shume apo destinimit të saj, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, për efekt të këtij procesi, gjurmimi i transaksionit përmes bankës është i pamjaftueshëm për ta konsideruar vlerën prej 10.000 eurosh, të marrë nga A. M. në dhjetor 2010, si burim për blerjen e 33% të aksioneve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA në vitin 2014, në vlerën 3.300.000 lekë, dhe për ta përfshirë atë në analizën financiare të kryer në kuadër të verifikimeve përkatëse.

16. Lidhur me shumën 600.000 lekë, të deklaruar me burim të ardhurat nga avokatia për vitin 2011, ushtruar me NIPT {\*\*\*}.

16.1. Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion deklarimin e saj dhe, si pasojë, shuma 600.000 lekë nuk mund të konsiderohet si burim i ligjshëm për shumën e derdhur në kapitalin e shoqërisë.

16.2. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit për këtë çështje, vlerësoi si më poshtë:

16.2.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur me subjektin, në rubrikën “Angazhime dhe veprimtari private dhe ose publike”, nuk ka deklaruar të ardhura të realizuara nga aktiviteti i personit fizik “A. M.”, me NIPT {\*\*\*}, për vitin 2011.<sup>19</sup>

16.2.2. Nga informacioni që QKB-ja ka përcjellë në Komision, rezulton që A. M. është regjistruar si person fizik më datë 18.01.2010, me NIPT {\*\*\*}, pezulluar më datë 17.08.2016, dhe çregjistruar më 10.01.2018.

16.2.3. Referuar vërtetimit nr. {\*\*\*} prot., datë 27.05.2019<sup>20</sup>, lëshuar nga Dhoma e Avokatisë së Shqipërisë, rezulton se: *A. M., me licencë nr. {\*\*\*}, është anëtar i Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë dhe ushtron profesionin e avokatit pranë Dhomës së Avokatisë Tiranë prej vitit 2003 deri në vitin 2016. Prej vitit 2017 dhe në vazhdim, ka kaluar në regjistrin e avokatëve pasivë, për shkak të papajtueshmërisë ligjore për ushtrimin e avokatit, parashikuar nga neni 7 i ligjit nr. 55/2018, “Për profesionin e avokatit në Republikën e Shqipërisë”, pasi ushtron detyra në administratën publike.*

16.2.4. Sipas vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, sjellë në Komision nga subjekti i rivlerësimit me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, rezulton që, për vitin 2011, është deklaruar qarkullim vjetor në nivelin 0-2 milionë lekë dhe janë likuiduar detyrimet, në total 45.245 lekë.

16.2.5. Gjatë hetimit administrativ në Komision, organet tatimore<sup>21</sup> kanë informuar se e ardhura e deklaruar në vitin 2011 nga aktiviteti i personit fizik “A. M.”, me NIPT {\*\*\*} është 0 (zero) lekë, dhe se në atë vit, ky aktivitet ka rezultuar me humbje prej (-) 28.500 lekësh.

16.2.6. Mbështetur në sa sipër, trupi gjykues i Kolegjit ka vlerësuar të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos përfshirë në analizën financiare të kryer prej tij, të ardhurat e pretenduara në vitin 2011 nga aktiviteti i personit fizik “A. M.”, me NIPT {\*\*\*}, për sa kohë nuk provohet me dokumentacion justifikues ligjor realizimi i këtyre të ardhurave në masën e pretenduar.

---

<sup>19</sup> Personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga ky aktivitet, që i përkasin vitit 2010. Referuar informacionit të përcjellë në ILDKPI nga DPT-ja dhe DRT-ja, ka rezultuar që fitimit neto i realizuar nga “A. M.”, person fizik me NIPT {\*\*\*}, për vitin 2010 ka qenë 305.213 lekë, ndërkohë që është deklaruar prej tij në deklaratën e pasurisë *vetting*, në vlerën 274.692 lekë, sikurse ka deklaruar, 840.386 lekë për vitin 2014, vlerën 517.000 lekë për vitin 2015, dhe 1.295.596 lekë për vitin 2016.

<sup>20</sup> Sjellë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

<sup>21</sup> Komunikimi me DPT-në, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.03.2021; Komunikimi me DRT-në, shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 21.12.2023.

17. *Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit të deklaruar si të përfituara nga familja bujqësore*

17.1. Komisioni ka vlerësuar se nuk mund të përfshihen në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit, të ardhurat e pretenduara me burim familjen bujqësore, pasi subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë deklaruar të ardhura të përfituara nga aktiviteti bujqësor i familjes së këtij të fundit, në deklaratimet periodike apo në deklaratën e pasurisë *vetting*. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ u provua që personi i lidhur me subjektin banonte dhe punonte në mënyrë të vazhdueshme në qytetin e Tiranës, dhe për këtë arsye, nuk janë aplikuar shpenzime jetike të reduktuara.

17.2. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit pretendon se konkluzionet e Komisionit rezultojnë tërësisht të pabazuara, për sa kohë që gjatë hetimit administrativ rezultoi e provuar se:

(i) Familja e personit të lidhur me subjektin është trajtuar me tokë bujqësore sipas parashikimeve të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”, fakt ky i konfirmuar nga institucionet shtetërore kompetente dhe i deklaruar nga ai që në deklaratën e parë të tij, në vitin 2014. Qëllimi i këtij ligji ishte pikërisht ushtrimi i aktivitetit bujqësor e blegtoral privatisht, duke përdorur këto sipërfaqe toke nga subjektet përfituese të tij.

(ii) Prindërit e personit të lidhur me subjektin, sikurse provojnë aktet e lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore, kanë qenë të punësuar si mësues dhe nuk kanë pasur detyrimin për t’u regjistruar për herë të dytë pranë organeve tatimore, si të vetëpunësuar në bujqësi. A. M. ka qenë i regjistruar në të njëjtën përbërje të gjendjes civile të familjes, dhe të ardhurat e realizuara kanë qenë në një ekonomi të përbashkët.

(iii) Legjislacioni tatimor i kohës nuk parashikonte regjistrimin e aktivitetit bujqësor e blegtoral apo deklarimin e të ardhurave të realizuara nga ky aktivitet, për pasojë edhe pagimin e detyrimeve tatimore lidhur me to, ndërkohë që detyrimet tatimore për sipërfaqen e tokës bujqësore janë shlyer rregullisht.

(iv) Mendimi teknik i dhënë nga ekspertja e fushës së agronomisë konfirmon mundësinë e realizimit të të ardhurave sipas viteve përkatëse, në vlera të konsiderueshme.<sup>22</sup>

17.3. Po ashtu, subjekti i rivlerësimit, sa i përket konkluzioneve të Komisionit lidhur me vlerësimin e burimeve të realizuara nga personi i lidhur, kërkon nga ana e Kolegjit të mbahet në konsideratë që: (a) ato nuk lidhen me pamjaftueshmëri të burimeve financiare të subjektit të rivlerësimit; (b) problematikat lidhen me të ardhurat e personit të lidhur me të, në një periudhë kur ajo nuk ka qenë subjekt deklarimi dhe këto pasuri nuk lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë me interesa pasurorë të vetë subjektit të rivlerësimit, dhe se (c) çdo transaksion i kryer lidhur me pasuritë është lehtësisht i verifikueshëm. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjithashtu reduktimin e shpenzimeve

---

<sup>22</sup> *Subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit administrativ, i ka paraqitur Komisionit “Raport Vlerësimi” për përlllogaritjen e të ardhurave të realizuara nga toka bujqësore, përgatitur nga eksperte e licencuar, L. B. Në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se në deklaratën e pasurisë *vetting* është deklaruar nga personi i lidhur zotërimi i një toke bujqësore dhe gjithashtu ajo është përfshirë në deklaratën e parë të pasurisë së tij, në të cilën ka deklaruar “të ardhura nga familja bujqësore”, por pa specifikuar një vlerë konkrete pasi këto të ardhura janë përfituar nga familja bujqësore, Ndërkohë që në legjislacionin tatimor, sidomos përpara vitit 2014, nuk ka ekzistuar detyrimi i personave që jetonin në fshat të dokumentonin me faturë apo ndonjë mënyrë tjetër të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore. Në vitin 2016, të ardhurat nga toka bujqësore janë të dokumentuara për shkak se në këtë vit toka u dha me qira. Siç rezulton nga akti ekspertimi, toka bujqësore është kultivuar në çdo vit dhe ka krijuar të ardhura për familjen bujqësore, ku anëtar ka qenë edhe A. M., para fillimit të bashkëjetesës.*

të jetesës në masën 44%, në kushtet kur personi i lidhur me të ka realizuar të ardhura nga aktivitet bujqësor dhe ka konsumuar produktet bujqësore të prodhuara, sikurse është vepruar në jurisprudencën e krijuar në këtë drejtim, duke referuar vendimin e Kolegjit nr. 20/2022 (JR).

17.4. Për sa sipër, trupi gjykues i Kolegjit, pasi analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit dhe pasi shqyrtoi aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit për këto të ardhura, vlerësoi si më poshtë:

17.4.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar: *Të ardhura në total “1.078.418 lekë”, për familjen bujqësore me kryefamiljar V. M. nga: (i) qira nga toka bujqësore; (ii) kompensim; (iii) servituti i përfiturar. Të ardhurat janë nga shoqëria “{\*\*\*}”, degë e shoqërisë së huaj në Shqipëri, me NIPT {\*\*\*} dhe adresë Godina {\*\*\*}, “{\*\*\*}”, [...]. Shuma “300.000 lekë”.* Në funksion të deklarimeve, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* është paraqitur:

(i) Kontratë servituti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.01.2016, me palë znj. V. M. dhe shoqërinë “{\*\*\*}” (në vijim “{\*\*\*}” ShA), nëpërmjet së cilës është krijuar një e drejtë servituti mbi një parcelë të llojit “arë” me sipërfaqe 736 m<sup>2</sup> dhe numër pronësie {\*\*\*}, zona kadastrale {\*\*\*}, në pronësi të nënës së personit të lidhur me subjektin. Sipas kontratës, vlera për dhënien e këtyre të drejtave shoqërisë përfituese të sipërcituar, është në shumën 366.528 lekë.

(ii) Deklaratë noteriale për kompensim nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.01.2016, me anë të së cilës shoqëria “{\*\*\*}” ShA ofron kompensim për të mbjellat dhe/ose strukturën që do të zhvendoset, me qëllim zhvillimin e punimeve për projektin, i cili do të zhvillohet mbi pasurinë “arë”, në pronësi të nënës së personit të lidhur me subjektin, me numër pasurie {\*\*\*}, ndodhur në z. k. {\*\*\*}. Vlera e kompensimit të përcaktuar në deklaratën noteriale është në shumën 22.160 lekë.

(iii) Kontratë qiraje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.01.2016, me palë znj. V. M. dhe shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, me objekt marrjen me qira nga ana e shoqërisë të sipërfaqes 2.770 m<sup>2</sup> nga sipërfaqja e përgjithshme prej 12.430 m<sup>2</sup> të pasurisë “arë”, në pronësi të nënës së personit të lidhur me subjektin. Vlera e qirasë për një periudhë 24-mujore është në shumën 689.730 lekë.

17.4.2. Në deklaratën e interesave privatë 2014, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar tokën bujqësore në pronësi, por nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti bujqësor, deri në deklaratën periodike të vitit 2016, në të cilën deklaroi të ardhura nga kontrata e lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA.

17.4.3. Sa më sipër, të ardhurat e deklaruara nga personi i lidhur në deklaratën e pasurisë *vetting* nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, datojnë në vitin 2016, pas kohës së krijimit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA në shtator të vitit 2014. Në kushtet kur Komisioni ka konstatuar se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit apo vetë subjekti i rivlerësimit, nuk kanë deklaruar në deklaratat periodike të ardhura nga aktiviteti bujqësor, si dhe nuk rezultojnë prova të dokumentuara nga institucionet për gjenerimin e këtyre të ardhurave nga familja bujqësore, në kuadër të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, i ka kaluar subjektit të rivlerësimit barrën e provës, për të paraqitur prova ose shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e konstatimeve.

17.4.4. Me prapësime për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision “Raport Vlerësimi” për përllogaritjen e të ardhurave nga toka bujqësore, përgatitur nga eksperte e licencuar L. B., dhe ka shpjeguar se: [...] Në deklaratën e parë të pasurisë, bashkëshorti/bashkëjetuesi ka deklaruar “të ardhura nga familja bujqësore”, por pa specifikuar

*një vlerë konkrete, sepse këto të ardhura janë përfituar nga familja bujqësore, por në legjislacionin tatimor, sidomos përpara vitit 2014, nuk ka ekzistuar detyrimi i personave që jetonin në fshat të dokumentonin me faturë apo ndonjë mënyrë tjetër të ardhurat e realizuara nga toka bujqësore. Në vitin 2016, të ardhurat nga toka bujqësore janë të dokumentuara, për shkak se në këtë vit toka u dha me qira, etj. Meqenëse bashkëshorti ka pasur të ardhura dhe produkte nga toka bujqësore, shpenzimet jetike të tij deri në fund të vitit 2014 duhet të reduktohen në masën 44%, ashtu siç është konsoliduar praktika e trupave të rivlerësimit në këtë drejtim.*

17.4.5. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se në deklaratën e interesave privatë 2014, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka deklaruar: *“Tokë arë me sipërfaqe totale 16 900 m<sup>2</sup>, nga të cilat 200 m<sup>2</sup> truall dhe ndërtim 93 m<sup>2</sup>. Pasuria ndodhet në {\*\*\*}, Lushnjë”*. Burimi i krijimit: *ligji nr. 7501/1991, për shkak të familjes bujqësore, pasuria është në bashkëpronësi ideale me familjen bujqësore dhe administrohet bashkërisht*. Pjesa takuese: *“23%”*. Ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit në shkaqet e ankimit, personi i lidhur me të, nuk rezulton të ketë deklaruar në këtë vit të ardhura nga familja bujqësore. Deklarimi i zotërimit/përfitimit të tokës bujqësore nuk nënkupton, për efekt të këtij procesi, realizimin e të ardhurave nga shfrytëzimi i saj. Në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit janë trajtuar gjerësisht: (i) pretendimet e subjekteve mbi realizimin e të ardhurave të deklaruara nga aktiviteti bujqësor; (ii) detyrimi ligjor për të paguar tatimet lidhur me to, në rastin kur këto të ardhura janë deklaruar dhe është provuar realizimi i tyre, si dhe (iii) rastet kur shpjegimi bindshëm i realizimit të tyre ka ndikuar në reduktimin e shpenzimeve të jetesës.

17.4.6. Gjatë hetimit administrativ, në funksion të provueshmërisë të realizimit të ardhurave nga toka bujqësore, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision këto akte: (1) Vërtetim nga Bashkia Lushnjë, Njësia Administrative Bubullimë, Zyra e Tatim Taksave, me anë të cilit vërteton *se familja bujqësore e z. U. B. M., nuk ka detyrime për taksën e tokës bujqësore*; (2) Dokumentet e pronësisë së tokës bujqësore, dhe (3) Raportin e Vlerësimit për të ardhurat nga toka bujqësore të familjes *M.*, të hartuar nga eksperte L. B.,<sup>23</sup> të cilat nuk janë të mjaftueshme për të provuar realizimin e të ardhurave pretenduara nga aktiviteti bujqësor i kësaj familje ndër vite.

17.4.7. Të dhënat e raportit të vlerësimit për të ardhurat nga toka bujqësore e familjes *M.*, hartuar nga eksperte L. B., bazohen kryesisht mbi certifikatat e pronësisë të tokës bujqësore dhe mundësinë hipotetike të shfrytëzimit të saj, por nuk gjejnë mbështetje në dokumentacion provues, i cili vërteton realizimin e tyre në masën e pretenduar. Në këto kushte, në vlerësim të trupit gjykues, nuk gjendet i bazuar as pretendimi i subjektit të rivlerësimit dhe referencat në jurisprudencën e Kolegjit në këtë drejtim, me të cilat e përbashkëta qëndron vetëm në ekspertin që ka hartuar raportin dhe jo dokumentacionin mbi të cilin ai është mbështetur, apo në rrethanat e konstatuara, të lidhura me deklarin dhe nivelin e besueshmërisë së këtyre deklarimeve.

17.4.8. Këto të ardhura nuk janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në deklaratat periodike vjetore nga ana e personit të lidhur me subjektin. Gjithashtu, nuk u arrit të provohej dhe as të shpjegohej bindshëm shfrytëzimi i tokës bujqësore në drejtim të krijimit të besueshmërisë për realizimin e prodhimeve bujqësore në funksion të reduktimit të shpenzimeve të jetesës, sikurse ka pretenduar subjekti i rivlerësimit.

---

<sup>23</sup> Raporti i vlerësimit, shoqërohet me dokumentacionin teknik: (1) Akti i marrjes në pronësi të tokës; (2) harta treguese e pasurive; (3) fotografimet ajrore të parcelave, si dhe (4) fotografi të kryera në momentin e inspektimit.

17.4.9. Sa i përket pretendimeve të tjera të ngritura nga subjekti, të lidhura me punësimin e prindërve të personit të lidhur, si mësues, ekonomisë së përbashkët familjare, prezencës së personit të lidhur në qytetin e Lushnjës, përfshirë këtu dhe angazhimet publike dhe private me familjen e tij, si dhe faktit se janë shlyer detyrimet për taksën e tokës bujqësore, në vlerësimin e trupit gjykues janë pa ndikim në drejtim të provueshmërisë së realizimit të të ardhurave të pretenduara. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore, të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si burim për krijimin e aksioneve në “{\*\*\*}” ShA, të padeklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe ato periodike vjetore, nuk u provuan me dokumente ligjore nga ato që parashikon neni 49 i ligjit nr. 86/2016, duke mbetur në nivel deklarativ, ndaj vlerësohet i drejtë konkluzioni i Komisionit për të mos i përfshirë ato në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të.

17.4.10. Për gjithë sa më lart arsyetuar, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk provoi që si burim i krijimit të aksioneve në “{\*\*\*}” ShA, të kenë shërbyer: (i) të ardhurat në shumën 10.000 euro që personi i lidhur ka marrë nga shtetasi R. Z., më datë 27.12.2010; (ii) të ardhurat në vlerën 600.000 lekë për vitin 2011, të pretenduara nga aktiviteti si person fizik “A. M.” me NIPT {\*\*\*}, si dhe (iii) të ardhurat e pretenduara nga shfrytëzimi i tokës bujqësore.

17.4.11. Në këto rrethana, edhe pse trupi gjykues kreu nëpërmjet Njesisë së Shërbimit Ligjor analizën financiare sipas metodologjisë kumulative për periudhën para lindjes së detyrimit deklarues të bashkëjetuesit, 2001 – 31.12.2013, të pretenduar edhe nga vetë subjekti në ankim e parashtrime, rezultatet treguan sërish mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara në këtë periudhë, pasi nuk u arrit të provohet realizimi dhe ligjshmëria e të ardhurave të deklaruara prej subjektit dhe personit të lidhur me të, si burim të pasurive të krijuara gjatë kësaj periudhe, përfshirë edhe blerjen e aksioneve të “{\*\*\*}” ShA.

Në përfundim, lidhur me pasurinë aksione në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, në vlerën 3.300.000 lekë, trupi gjykues i Kolegjit ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë financiare të personit të lidhur A. M. për të justifikuar me të ardhura nga burime të ligjshme investimin e kryer në shtator të vitit 2014, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/2 Për pasurinë “Aksione në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA*

18. Komisioni, lidhur me këto aksione, ka arritur në përfundimin se: [...], subjekti ka pamundësi në krijimin e vlerës së blerjes së aksioneve në shumën totale (–) 8.303.809 lekë, pasi personi i lidhur nuk ka deklaruar gjendje kursimesh cash në fund të vitit 2012, të cilat mund të ishin krijuar nga të ardhurat e tij para fillimit të bashkëjetesës dhe të shërbenin për blerjen e aksioneve në këtë shoqëri.

18.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankim dhe parashtrime, kundërshton konkluzionin dhe arsyetimin e Komisionit<sup>24</sup> në drejtim të mospërfshirjes në analizën financiare të kryer prej tij, të të ardhurave që personi i lidhur me të ka përfituar nga shërbimet e konsulencës në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, gjatë viteve 2004 – 2006. Sipas subjektit, personi i lidhur A. M., nuk ka qenë në marrëdhënie pune me shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, siç ka konstatuar Komisioni në vendim, por ka qenë në marrëdhënie të këshillimit juridik, në bazë të së cilës, për shërbimet e ofruara i janë paguar honorare dhe jo pagë

<sup>24</sup> Subjekti referon në shkaqet e ankimit arsyetimin e Komisionit, në paragrafin 50.17 të vendimit të tij.

mujore. Subjekti pretendon të ketë paraqitur prova të konsiderueshme gjatë hetimit administrativ në Komision, që vërtetojnë ekzistencën e marrëdhënies së shërbimit të këshillimit juridik të personit të lidhur, duke referuar konkretisht:

(1) Shkresën “Kthim përgjigje”, datë 07.07.2023, drejtuar shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në të cilën, administratorja e asaj kohe informon se A. M., gjatë vitit 2005, ka qenë një nga bashkëpunëtorët më të rëndësishëm të kësaj shoqërie në drejtim të këshillimit juridik dhe për të gjithë punën e angazhimit e dhënë, është shpërblyer në vlerën 4.800.000 lekë.

(2) Deklaratë noteriale nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 20 gusht 2024, në të cilën administratorja e shoqërisë deklaroi se A. M., në vitet 2004, 2005 dhe 2006 ka qenë konsulent i shoqërisë, dhe ka mbuluar rubrikën e çështjeve ligjore për të gjitha llojet e botimeve të saj, gazetës “Shekulli”, revistës “Spektër” etj. Bashkëlidhur deklaratës janë paraqitur: (i) Kopje e gazetës “Shekulli” e vitit 2006 e cila botohej nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, me rubrikë të veçantë për shpjegime lidhur me çështje juridike, në të cilën A. M. jepte shpjegime për kërkesat e lexuesve, dhe (ii) Shkresa “Kthim përgjigje” nga Drejtoria Rajonale Tatimore, Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 20 gusht 2024, me të cilën është përcjellë kopje bilanci e shoqërisë për vitin 2005. Nëpërmjet këtij bilanci, subjekti pretendon se është provuar që kjo shoqëri ka kryer pagesat në zërin “*honorare*” dhe ka mbajtur në cilësinë e agjentit tatimor, detyrimin përkatës. Subjekti pretendon se pagesa e tatimit në burim paguhet pa specifikuar zërat përkatës, për shkak se legjislacioni tatimor nuk kërkonte një specifikim të kësaj natyre.

(3) Shkresë “Njoftim Vlerësimi për Detyrimet”, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.11.2006, nga DPT, Sektori i Vlerësimit Tiranë, përmes të cilit njoftohet shoqëria “{\*\*\*}” ShA, *për detyrime të papaguara për periudhën tatimore të vitit 2004*, me të cilën subjekti pretendon të provojë që shoqëria nuk ka detyrime të tatimit në burim të papaguara për vitin 2005.

**18.1.1.** Ky dokumentacion provon, sipas subjektit, ekzistencën e marrëdhënies së këshillimit juridik të personit të lidhur me këtë shoqëri dhe konfirmon, pa asnjë mëdyshje, ekzistencën e ofrimit të shërbimit të këshillimit juridik në vitet 2004 – 2006<sup>25</sup>. Subjekti i rivlerësimit nuk bie dakord me arsyetimin e Komisionit që nuk u provua shlyerja e detyrimeve tatimore për shumën e përfituar në këtë kuadër, duke pretenduar se ky konkluzion është i gabuar dhe është bërë pa një analizë të saktë të kuadrit ligjor përkatës, pasi detyrimi për të paguar tatimin në burim e ka pasur subjekti “{\*\*\*}” ShA. Nga ana e Komisionit është anashkaluar vlera provuese e aktit “*Njoftim Vlerësimi për Detyrimet nr. {\*\*\*} prot., datë 10.11.2006*”, në bazë të të cilit vërtetohet se deri në datën 31.08.2006, shoqëria ka pasur për të paguar vetëm interesa për tatim fitimin e vitit 2004, në vlerën 306.336 lekë, dhe jo detyrime të tjera si tatim në burim mbi të ardhurat etj. Sipas subjektit në ankim e parashtrime, në këtë rast, relevant është fakti që shoqëria e cila ka detyrimin për të paguar detyrimin tatimor, ka deklaruar saktësisht në pasqyrat financiare, të gjithë shpërblimet dhe trajtimet që ka kryer për këshilltarët dhe gazetarët e punësuar pranë saj gjatë vitit 2005. Si rrjedhojë, këto të ardhura për subjektin, plotësojnë kushtet e të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

---

<sup>25</sup> Subjekti referon vendimin nr. 23, datë 15.03.2018 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në të cilin është pranuar se “*Kështu deklaratat e shkruara të të tretëve jo pjesëmarrës në proces, kanë formën e shkresave private, por në përmbajtje kanë elementë të dëshmisë, për sa kohë mund të jenë deklarime të personave të painedësuar në përfundimin e çështjes mbi faktet për të cilat ata kanë dijeni*”.

18.1.2. Duke pretenduar se personi i lidhur me subjektin ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e aksioneve në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA në vitin 2013, balanca negative për këtë vit duhet të ndryshohet, duke reflektuar të gjitha të ardhurat e përfituara nga ana e personit të lidhur, të cilat kalojnë testin e besueshmërisë mbi ligjshmërinë e tyre të parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës.

18.2. Trupi gjykues i Kolegjit pasi shqyrtoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit, aktet shkresore të administruara në dosjen gjyqësore të Komisionit për këtë pasuri/aksione, konstaton si më poshtë:

18.2.1. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar: “*Të ardhura të pritshme nga kontrata e shitjes së aksioneve z. J. J., sipas kontratës nr. {\*\*\*} kol., nr. {\*\*\*} rep., datë 23.3.2016. Vlera 8.000.000 lekë. Pjesa takuese 100%*<sup>26</sup>”. Personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2016<sup>27</sup>, shitjen e aksioneve të kësaj shoqërie.

18.2.2. Në deklaratën e interesave privatë 2014, personi i lidhur me subjektin deklaron: *Aksione në “{\*\*\*}” ShA, NIPT {\*\*\*}, me adresë {\*\*\*}, Elbasan. Zotëroj 30.000 aksione, blerë sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol., dt. 11.09.2013, para noteres M. D. Burimi i krijimit: Të ardhurat e mia. Vlera: “30.000 aksione me vlerë 49.980.000 lekë”. Pjesa takuese: “30%”.*

18.2.3. Në deklaratën e interesave privatë 2015, personi i lidhur me subjektin deklaron: “*Rritur numri i aksioneve në shoqërinë aksionare, në bazë të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 12.11.2015, të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë, për zmadhimin e kapitalit. Burimi i krijimit: Fitimi i shoqërisë është destinuar për zmadhim kapitali sipas vendimit nr. {\*\*\*}”.*

18.2.4. QKB<sup>28</sup> konfirmon pronësinë e bashkëjetuesit të subjektit, A. M., të 30,32% të aksioneve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, me NIPT {\*\*\*}, të themeluar më datë 02.08.1995 dhe regjistruar më 07.07.1996. Nga informacioni i QKB-së rezultojnë të jetë nënshkruar kontratë shitblerje (aksione) nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2013<sup>29</sup> mes shitësit K. K. dhe blerësit A. M., për transferimin e 30% të aksioneve të tij në favor të këtij të fundit, apo 27.660 aksione, kundrejt pagimit të vlerës totale 8.303.809 lekë, e cila do t’i likuidohet shitësit nga blerësi jashtë zyrës noteriale, në një rreth prej formave të njohura nga ligji shqiptar. Me vendimin e datës 23.09.2013, të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, numri i aksioneve të A. M. është rritur në 31.980, për shkak të zmadhimit të kapitalit nga fitimi i realizuar për vitin ushtrimor 2012. Me vendimin nr. {\*\*\*} të Asamblesë së Aksionarëve të datës 24.11.2014, numri i aksioneve të bashkëjetuesit të subjektit në këtë shoqëri, është rritur në 49.980. Me vendimin nr. {\*\*\*} të Asamblesë së Përgjithshme të Aksionarëve, datë 09.11.2015, numri i aksioneve të tij është rritur në 66.900, për shkak të zmadhimit të kapitalit nga fitimi i realizuar në vitin paraardhës, deklaruar kjo edhe në deklaratën e interesave privatë 2015. Më datë 09.11.2015, bashkëjetuesi i subjektit është emëruar edhe anëtar i Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë, pozicion nga i cili është larguar më datë 16.05.2016.

<sup>26</sup> Aneks nr. 4/24, bashkëlidhur deklaratës; Kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.03.2016, ku A. M. shet 66.900 aksione që zotëron në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit të saj. Çmimi i shitjes që blerësi do t’i paguajë shitësit për shitjen e aksioneve është 8.310.000 lekë, çmimi i cili do të paguhet nëpërmjet bankës nga blerësi. Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2017, i njësish me origjinalin; Ekstrakt i Regjistrimit Tregtar nga QKB, data e themelimit 02.08.1995, datë printimi 23.01.2017, ku aksionari J. J. zotëron 60,310 përqindje pjesëmarrje; Kontratë shitblerje aksionesh nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.09.2013, ku A. M. blen 27.660 aksione me vlerë 8.303.809 lekë, vlerë e cila do të likuidohet jashtë zyrës noteriale. Vërtetim nr. {\*\*\*} prot., datë 21.01.2017 i njësish me origjinalin.

<sup>27</sup> Të dorëzuar më datë 29.03.2017.

<sup>28</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 04.03.2021.

<sup>29</sup> Depozituar nga subjekti me përgjigjet për pyetësin e ILDKPKI-së, datë 07.03.2016.

18.2.5. Blerja e aksioneve në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA provohet me kopje të mandatarkëtimit të vlerës 8.303.809 lekë, të derdhur nga A. M. për llogari të K. K., në Credins Bank ShA, më datë 12.09.2013, me përshkrim: *A. M., sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., dt. 11.09.2013*, paraqitur në ILDKPKI, nga subjekti i rivlerësimit.

18.2.6. Me kontratë shitblerje aksionesh nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.03.2016, A. M. në cilësinë e shitësit, i ka shitur blerësit J. J., 66.900 aksionet që ai zotëron në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, të cilat përfaqësojnë 30% të kapitalit të saj, kundrejt çmimit të shitjes 8.310.000 lekë, *i cili do të paguhet në mënyrë bankare nga blerësi.*

18.2.7. DPT<sup>30</sup> ka përcjellë në Komision informacion mbi aktivitetin e shoqërisë, si dhe kopje të deklaratave të tatimit fitimit për vitet 2015 – 2016, nga ku rezulton që statusi i shoqërisë është *aktiv* prej datës 22.02.2001, dhe se është nën juridiksionin e Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasan. Sipas “*Deklaratës së Fitimit 2015*”, të ardhurat e realizuara nga kjo shoqëri kanë qenë në vlerën 140.915.657 lekë dhe fitimi para tatimit në vlerën 100.774.056 lekë, ndërsa për vitin 2016, të ardhurat janë deklaruar në vlerën 170.709.711 lekë dhe fitimi para tatimit në vlerën 107.589.626 lekë. Nuk rezulton nga të dhënat e dokumentacionit të përcjellë nga DPT në Komision, që personi i lidhur me subjektin, bashkëjetuesi i saj, të ketë përfituar të ardhura nga pagat apo dividend, pasi gjatë këtyre viteve, nuk dokumentohet që shoqëria “{\*\*\*}” ShA, të ketë shpërndarë fitim neto në formë dividendi, deri në momentin e largimit të tij nga kjo shoqëri, më 16.05.2016.

18.2.8. Lidhur me burimin e shumës 8.303.809 lekë, e cila ka shërbyer për blerjen e aksioneve të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në vitin 2013, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar:

1) Burimi i krijimit të kësaj shume: *4.800.000 lekë të ardhura nga angazhimi në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA.* Në këtë shoqëri, personi i lidhur është paguar për konsulencën e dhënë mbi të drejtën e autorit, çështjet ligjore që lidhen me botimet, këshillimin mbi pretendimet e subjekteve që kanë qenë objekt shkrimesh në gazetë etj. Po ashtu, ka pasur publikime në gazetë e kohës për rubrikën e shpjegimeve të çështjeve ligjore. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bilancin e këtyre viteve, si dhe kopje të librave të botuar në periudhën e angazhimit, për të cilët është ndjekur nga personi i lidhur procesi që lidhet me të drejtën e autorit.

2) *1.300.000 lekë të ardhura nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA*, ku personi i lidhur ka mbajtur detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës nga data 31.12.2009, dhe të kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës nga data 10.02.2010.

3) *1.100.000 lekë nga të ardhurat nga paga në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA*, ku ka mbajtur detyrën e administratorit të shoqërisë nga data 22.07.2010 deri më 17.01.2012, me pagë mujore 80.000 lekë. Kursimet nga të ardhurat si administrator janë përdorur për të financuar blerjen e aksioneve.

4) *Të ardhurat nga avokatia kryesisht të vitit 2011*, statusi *aktiv* provohet sipas ekstraktit bashkëlidhur lëshuar nga QKB.

5) *Të ardhura të realizuara nga përdorimi dhe kultivimi i tokës bujqësore*, administruar së bashku me familjen e tij. [...]

---

<sup>30</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 08.03.2021.

**18.2.9.** ISSh-ja<sup>31</sup> informon Komisionin se, për periudhën 2005 – 2012, u kontrolluan dosjet nr. {\*\*\*} dhe nr. {\*\*\*}, dhe rezultoi që emri A. M. nuk figuron në listëpagesat që ata administrojnë për këtë subjekt.

**18.2.10.** Mbështetur në arsyetimet se: (i) DRT-ja<sup>32</sup> dhe ISSh-ja<sup>33</sup> nuk përcjellin informacion në lidhje me të ardhurat e përfituara nga personi i lidhur, nga shoqëritë “{\*\*\*}” ShA dhe “{\*\*\*}” ShA; (ii) ka përfiturar të ardhura nga paga në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, prej vitit 2010 deri shkurt 2012, me vlerë totale neto 1.273.769 lekë; (iii) personi i lidhur ka realizuar të ardhura nga fitimi neto prej aktivitetit privat si personi fizik në subjektin tatimpagues “A. M.”, me NIPT {\*\*\*}, për periudhën 2010 – 2012, me vlerë totale 274.692 lekë; (iv) nuk u provua përfitimi i të ardhurave nga bujqësia; (v) në lidhje me të ardhurat e tjera të mundshme të përfituara nga personi i lidhur para fillimit të bashkëjetesës (deri në mars 2011), rezultoi nga trajtimi në pasurinë apartament në rrugën “{\*\*\*}”<sup>34</sup>, se subjekti kishte pamundësi financiare në këtë periudhë, ndërsa nga analiza financiare pas fillimit të bashkëjetesës me subjektin e rivlerësimit, nuk rezultoi të jenë deklaruar kursime *cash* prej tyre, të cilat do të kishin shërbyer si burim krijimi për blerjen e aksioneve të shoqërisë më datë 11.09.2013, Komisioni, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, sa i përket pamundësisë financiare të rezultuar për krijimin e vlerës së paguar për blerjen e kuotave të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA.

**18.2.11.** Në prapësime për rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit i ka qëndruar pretendimeve se bashkëjetuesit i ka lindur detyrimi për deklarim në vitin 2014, se këto pasuri janë krijuar përpara martesë dhe me të ardhura tërësisht personale të tij, ndaj rezultati i analizës financiare nuk duhet të ndikojë në procesin e rivlerësimit të kryer për të. Sipas subjektit, në analizën financiare të kryer nga Komisioni, duhen përfshirë 1.300.000 lekë të ardhura nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, në të cilën bashkëshorti ka mbajtur detyrën e anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës dhe të kryetarit të këtij Këshilli, si dhe të ardhurat në vlerën 4.800.000 lekë të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA.

**18.2.12.** Për pasurinë *aksione* të personit të lidhur në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, Komisioni në vendim ka çmuar se, u provua bindshëm që shtetasi A. M. ka qenë kryetar i Këshillit Mbikëqyrës nga data 10.2.2010 deri në datën 06.05.2013, në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA. Ndërsa, nga pasqyrat financiare të shoqërisë [...], vërtetohet se zëri “Shpenzime të tjera” është në vlerën 4.715.505 lekë dhe nga llogaria analitike e saj shihet se nënzëri “Honorare” është me vlerë 1.718.462 lekë. Pra, rezultoi se kjo shumë është e mjaftueshme për mbulimin e pagesës së tatimit mbi vlerën e përfiturar nga personi i lidhur, dhe gjithashtu u konfirmua nga organet tatimore se shoqëria ka shlyer të gjithë vlerën e tatimit në burim për vitin 2010, e nuk ka detyrim të pashlyer për këtë vit. Komisioni ka vlerësuar kështu të përfshijë të ardhurat e personit të lidhur nga kjo shoqëri, në analizën e përditësuar të kryer prej tij.

**18.2.13.** Sa i përket të ardhurave të përfituara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA, Komisioni ka vlerësuar se subjekti nuk arriti të provojë marrëdhënien e punës së personit të lidhur me këtë shoqëri, si dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për shumën e pretenduar të përfiturar nga punësimi pranë saj, prandaj kjo vlerë nuk do të përfshihet në analizën financiare të përditësuar. Lidhur me të ardhurat e tjera të deklaruara si burim krijimi të këtyre aksioneve, rezultoi që Komisioni ka përfshirë në analizën financiare të kryer prej tij, të ardhurën neto prej 1.273.769 lekësh nga punësimi i personit të lidhur

<sup>31</sup> Shkresa e ISSh-së, nr. {\*\*\*} prot., datë 10.06.2024.

<sup>32</sup> Shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 21.12.2023.

<sup>33</sup> Shkresa ISSh, nr. {\*\*\*}, dt. 9.03.2021 dhe shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 13.06.2024.

<sup>34</sup> Trajtuar gjerësisht në vendimin e Komisionit.

në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, për periudhën shtator 2010 – dhjetor 2012, të konfirmuar nga ISSh. Ndërsa për të ardhurat nga avokatia, kryesisht të vitit 2011, dhe të ardhurat e realizuara nga përdorimi e kultivimi i tokës bujqësore, Komisioni ka mbajtur të njëjtin qëndrim sikurse trajtuar mbi burimet e krijimit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA.

**18.2.14.** Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të dokumentacionit të administruar në dosjen gjyqësore, konstaton se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit, nuk ka deklaruar të ardhura nga punësimi pranë shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, në deklaratën e pasurisë *vetting* apo në deklaratat periodike vjetore. Gjatë hetimit administrativ në Komision, nuk rezulton që nga organet tatimore apo ISSh, të jetë përcjellë informacion në lidhje me të ardhura të A. M. të përfituara nga punësimi në këtë shoqëri. Të ardhura të ligjshme, në funksion të kontrollit të kriterit pasuror në procesin e rivlerësimit, bazuar në kuadrin ligjor të zbatueshëm, por dhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit, konsiderohen ato të ardhura, të cilat sipas parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, janë deklaruar dhe për to janë paguar detyrimet tatimore, provuar dhe konfirmuar mbi bazën e dokumenteve nga institucionet përgjegjëse.

**18.2.15.** Në vlerësimin e trupit gjykues, duke i analizuar në tërësi aktet në fashikullin gjyqësor të Komisionit, subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion të plotë dhe të besueshëm për të provuar përfitimin real të këtyre të ardhurave. Realizimi i të ardhurave të pretenduara në vlerën 4.800.000 lekë, për atë periudhë, mbetet në nivel deklarativ, i padetajuar në ndonjë formë ligjore provuese që do të konfirmonte ekzistencën dhe gjendjen e saktë të tyre, pasi nuk ka lënë gjurmë në deklaratën e pasurisë *vetting*, në llogari bankare apo në ndonjë dokument tjetër ligjor, që të dëshmonte dhe provonte realizimin e tyre në masën e pretenduar. Për rrjedhojë, këto të ardhura, për efekt të këtij procesi, nuk kalojnë testin e provueshmërisë dhe të ligjshmërisë së tyre.

**18.2.16.** Deklaratat noteriale, kopjet e bilanceve apo të dhënat e pasqyrave financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShA, si dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit që shoqëria ka patur për të paguar vetëm interesa për tatim fitimin e vitit 2004, dhe jo detyrime të tjera tatimore, nuk janë të mjaftueshme për të legjitimuar pretendimet e saj mbi realizimin e të ardhurave të personit të lidhur nga punësimi në këtë shoqëri, në masën e pretenduar. Në këto kushte, edhe në këtë rast, nuk u provua realizimi dhe ligjshmëria e të ardhurave të pretenduara si burim për krijimin e pasurisë aksione në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, duke mbetur kështu e konfirmuar balanca negative e konstatuar nga Komisioni, për blerjen e tyre nga personi i lidhur, në vitin 2013, në vlerën (-) 2.909.550 lekë.

**18.2.17.** Në përfundim, lidhur me pasurinë aksione në shoqërinë “{\*\*\*}” ShA, në vlerën 8.303.809 lekë<sup>35</sup>, trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë mundësinë financiare të personit të lidhur me të, për të investuar me të ardhura nga burime financiare të ligjshme, për blerjen e këtyre aksioneve në shtator të vitit 2013, duke u gjendur kështu në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

*B/3 Lidhur me analizën financiare, për periudhën e rivlerësimit tetor 2006 – 2016*

19. Komisioni, pasi vlerësoi shpjegimet dhe provat e depozituara nga subjekti në prapësimet e rezultateve të hetimit, kreu analizën financiare për periudhën e rivlerësimit, nga e cila subjekti i

<sup>35</sup> Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur, bashkëjetuesi i subjektit të rivlerësimit A. M., ka deklaruar të ardhura të pritshme nga kontrata e shitjes së aksioneve z. J. J., sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.03.2016, në vlerën “8.000.000 lekë”.

rivlerësimi rezultoi me pamundësi financiare për vitet 2013 dhe 2014, në vlerën totale (-) 5.519.258 lekë<sup>36</sup>.

19.1. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se balanca negative e konstatuar për vitet 2013 dhe 2014, vjen për shkak të mosnjohjes së një pjese të të ardhurave që personi i lidhur me të ka siguruar nga punësimi, shërbimet dhe konsulencat e kryera për vite me radhë, kohë përpara se të mbante cilësinë e personit të lidhur apo të subjektit deklarues. Konstatimet dhe problematikat e evidentuara nga Komisioni lidhen vetëm me të ardhurat e bashkëjetuesit në një kohë kur ajo ende nuk njihej me të, fakt që përjashton tej çdo dyshimi që subjekti ka pasur mundësi të ndikojë nëpërmjet abuzimit me detyrën e saj, në krijimin e kësaj pasurie. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se nuk duhet të mbajë përgjegjësi disiplinore për rrethana që lidhen me veprimtarinë e personit të lidhur të saj. Sipas subjektit të rivlerësimit, këto rrethana kanë qenë jashtë dijenisë dhe kontrollit të saj. Komisioni duhet të kuptonte se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë lidhje me pasuritë e analizuar të personit të lidhur dhe për shkak të regjimit martesor, as nuk do të ketë në vazhdim ndonjë lidhje me aksionet e tij në shoqëritë “{\*\*\*}” ShA dhe “{\*\*\*}” ShA, të krijuara në shtator të vitit 2013 dhe shtator të vitit 2014, përkatësisht, për të cilat nuk ka shkëmbyer apo përfituar ndonjë interes prej tyre, për sa kohë shoqëritë nuk prodhuan asnjë të ardhur dhe për vetë personin e lidhur. Subjekti pretendon që, edhe në procesin e saj të rivlerësimit, të mbahet standardi i aplikuar nga Kolegji në vendimet nr. 19/2022 (JR) dhe nr. 20/2023 (JR), për të ardhurat e krijuara para bashkëjetesës. Për sa argumentuar në shkaqet e ankimit, subjekti i rivlerësimit kërkon që në analizën financiare kumulative të shtohen të ardhurat e realizuara nga personi i lidhur, konkretisht:

- (i) *Shuma 770.371 lekë, nga punësimi i personit të lidhur në zyrën avokatore “{\*\*\*}” ShPK;*
- (ii) *Shuma 3.802.102 lekë, si të ardhura nga toka bujqësore;*
- (iii) *Shuma prej 4.800.000 mijë lekë, e ardhur nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA;*
- (iv) *Shuma prej 1.388.100 lekë, nga transferta bankare nga shtetasi R. Z.;*
- (v) *Shuma prej 1.000.000 lekë, nga personi fizik “A. M.”, për vitin 2009, ku vetë Komisioni ka pranuar vlerën 400.000 lekë, me metodologji alternative;*
- (vi) *Diferenca 301.060 lekë, e cila është diferencë në tabelën në faqen 42 të vendimit, ku pasqyrohet shuma 9.112.721 lekë (të ardhurat e A. M. përpara bashkëjetesë), ndërkohë nga mbledhja matematikore rezulton se është 9.413.781 lekë;*
- (vii) *Shuma 105.000 lekë nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, si dhe*
- (viii) *Të njihet 44 % ulje e shpenzimeve jetike për shkak të faktit se bashkëjetuesi/bashkëshorti është bashkëpronar në tokën bujqësore.*

19.1.1. Subjekti i rivlerësimit shpjegon se në total shuma që nuk është njohur nga Komisioni, por që duhet të jetë pjesë e të ardhurave të bashkëjetuesit, është në vlerën 11.266.993 lekë. Kjo shumë e tejkalon dy herë mungesën e të ardhurave të vlerësuara nga Komisioni. Ulja e kostove të jetesës në masën 44 % krijon të ardhura shtesë për shpenzimet e tjera dhe ndikon në balancën e përgjithshme të bashkëjetuesit/bashkëshortit. Si konkluzion, subjekti i rivlerësimit pretendon se kalon testin e standardit kushtetues të të provuarit bindshëm të burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive.

---

<sup>36</sup> Kjo diferencë rezultoi pasi Komisioni vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me mungesën e pagesave të kryera nga ana e bashkëshortit, në krijimin e shoqërive të bastit. Referohuni në vendimin e Komisionit.

19.2. Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, për të përfshirë në analizën financiare të ardhurat e referuara në shkaqet e ankimit, konstaton dhe vlerëson se:

19.3. Për të ardhurat e deklaruara nga punësimi i personit të lidhur me shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK (në vijim “{\*\*\*}”), Komisioni ka vlerësuar të mos i përfshijë ato në të ardhurat e ligjshme në analizën financiare të kryer prej tij, pasi nuk u provuan me dokumentacion ligjor.

19.3.1. Subjekti i rivlerësimit, në shkaqet e ankimit, ngre pretendimin se nga ana e saj është depozituar bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, vërtetim i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, datë 23.01.2017, me të cilin konfirmohet se shtetasi A. M. ka qenë i punësuar pranë kësaj shoqërie, për periudhën prill – shtator 2009, dhe ka përfituar pagën neto 770.371 lekë. Pas zbardhjes së vendimit të Komisionit, nga ana e subjektit të rivlerësimit është siguruar edhe dokumenti i nënshkruar elektronikisht “Vërtetim për periudhë punësimi” me nr. {\*\*\*} prot., datë 02.09.2024, në përmbajtje të të cilit vërtetohet se nga kontrolli i dokumentacionit që administrohet pranë Drejtorisë së Arkivit Qendror në ISSh, në dosjen nr. {\*\*\*}, A. M. figuron në listëpagesat për periudhën prill – maj 2009 dhe korrik – gusht 2009. Ky vërtetim është administruar nëpërmjet platformës *e-Albania* për shërbimin përkatës të ISSh-së dhe përbën provë të plotë i mëvetësuar, por edhe bashkë me vërtetimin e lëshuar nga punëdhënësi. Duke pretenduar se: (1) vërtetohet punësimi i bashkëshortit pranë kësaj studioje ligjore; (2) këto të ardhura janë deklaruar prej tij si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në deklaratën e interesave privatë 2014; (3) personi i lidhur me subjektin i ka bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, vërtetim nga punëdhënësi i cili konfirmon punësimin dhe pagesën e kryer, fakt ky i vërtetuar edhe nëpërmjet shkresës së datës 02.09.2024, të ISSh-së, në cilësinë e provës së re shkresore, subjekti i rivlerësimit vlerëson se Kolegji duhet të korrigjojë analizën financiare për sa afektohet nga mosnjohja e kësaj të ardhure të ligjshme.

19.3.2. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se personi i lidhur me subjektin, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar: *Pagë neto avokat pranë zyrës ligjore “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, në periudhën prill – shtator 2009. Vlera “770.371 lekë”.* Në funksion të këtij deklarimi ka paraqitur, vërtetim të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, datë 23.01.2017, në të cilin administratorja e shoqërisë, D. L., deklaron se A. M. ka qenë i punësuar pranë kësaj zyre avokatore, në periudhën prill – shtator 2009, me pagë bruto 915.346 lekë dhe pagë neto 770.371 lekë.

19.3.3. Nga të dhënat e lëvizjeve të llogarisë të A. M. në Intesa Sanpaolo Bank<sup>37</sup> ShA, rezulton që, më datë 04.04.2008, i janë transferuar me përshkrimin “*transfer with check from A. M. and Sh. H. in favor of A. M.*”, vlerat: (i) 610 euro, në datën 04.04.2008; (ii) 300 euro, më datë 16.04.2008 dhe (iii) 150 euro, më datë 30.04.2010.

19.3.4. ISSh-ja<sup>38</sup> bën me dije se për subjektin “{\*\*\*}” ShPK, për periudhën 2007 – 2012, u kontrollua dosja me nr. {\*\*\*} dhe rezulton që, për periudhën 2006 – tetor 2008, nuk administrohen listëpagesa, ndërsa për periudhën nëntor 2008 – dhjetor 2012, emri A. M. nuk figuron në listëpagesat e këtij subjekti. Sa më sipër, Komisioni nuk e ka përfshirë këtë vlerë si të ardhur në analizën financiare të tij.

<sup>37</sup> Shkresa Intesa Sanpaolo Bank ShA nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2021.

<sup>38</sup> Shkresa ISSh, Drejtoria e Arkivit Qendror, Dega e Fondit Arkivor të Kontributeve, pas vitit 1994, Tiranë, nr. {\*\*\*} prot., dt. 10.06.2024.

19.3.5. Në prapësime në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit kundërshton këtë qëndrim të Komisionit duke pretenduar se: (i) vërtetohet punësimi i bashkëshortit pranë studios ligjore avokatore të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK; (ii) këto të ardhura janë deklaruar prej tij si në deklaratën *vetting* ashtu edhe në deklaratat periodike vjetore; (iii) bashkëjetuesi i subjektit i ka bashkëlidhur deklaratës të pasurisë *vetting* vërtetimin nga punëdhënësi, i cili konfirmon punësimin dhe pagesën e kryer nga kjo shoqëri. Për subjektin, sipas parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, detyrimi për pagimin e tatimit në burim, qoftë në kuadër të një marrëdhënie punësimi apo të një marrëdhënie që rrjedh nga një kontratë shërbimi, bie mbi subjektin tregtar që bën pagesën, duke referuar për këtë vendimin e Kolegjit nr. 35/2022 (JR)<sup>39</sup>. Si rrjedhojë, këto të ardhura, prapëson subjekti, plotësojnë kushtet e të ardhurave të ligjshme në kuptim të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

19.3.6. Në analizë të akteve të administruara gjatë hetimit, konstatohet që ISSh-ja, Drejtoria e Arkivit Qendror, informon se *për dosjen me nr. {\*\*\*}, rezulton që për periudhën 2006 – tetor 2008, nuk administrohen listëpagesa. Për periudhën nëntor 2008 – dhjetor 2012, emri A. M. nuk figuron në listëpagesat e subjektit “{\*\*\*}” ShPK.* Ndërkohë, nga vërtetimi për periudhë punësimi datë 02.09.2024, i sjellë nga subjekti me ankimin, lëshuar elektronikisht nga e njëjta drejtori pranë ISSh-së (1 fletë), referohet se nga kontrolli i dokumentacionit që institucioni administron deri në momentin e lëshimit të shkresës për subjektin “{\*\*\*}” ShPK, me dosje nr. {\*\*\*}, A. M. është i siguruar për periudhën prill – maj 2009 dhe korrik – gusht 2009. Për muajt qershor – shtator 2009, nuk administrohen listëpagesa. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit ka kryer edhe një analizë duke përfshirë të ardhurat nga ky punësim vetëm për periudhën që ISSh e konfirmon përfitimin e tyre [për katër muaj të vitit 2009 (770,371.5 lekë/6) x 4 = 513,580.66 lekë], shumë e cila ndryshon nga vlera e pretenduar nga subjekti, në shkaqet e ankimit.

19.3.7. Në kushtet e mungesës së kontratës së punës që provon ndër të tjera, natyrën e punës së dakordësuar mes punëdhënësit “{\*\*\*}” ShPK dhe personit të lidhur me subjektin e rivlerësimit, vlerën e pagës përkatëse, si dhe në mungesë të të dhënave mbi pagesat e pretenduara nga kjo marrëdhënie pune (lëvizjet bankare apo listëpagesat), trupi gjykues arrin në përfundimin se përfitimi i këtyre të ardhurave në vlerën e pretenduar, mbeti në nivel deklarativ, pa asnjë gjurmë për realizmin

---

<sup>39</sup> [...] 70. Në analizë të sa më sipër konstatuar, trupi gjykues, në konsideratë të faktit se marrëdhënia e punësimit pranë shoqërive tregtare “{\*\*\*}” ShPK, “{\*\*\*}” ShPK dhe “{\*\*\*}” ShPK konfirmohet nga vetë organi tatimor, si dhe se pagesat (pagat) mujore kanë kaluar nëpërmjet sistemit bankar dhe vlerat e derdhura në bankë përputhen me vlerat e deklaruara në vërtetimet e punëdhënëseve, si dhe me vlerat e deklaruara nga subjekti në deklaratimet periodike dhe atë të pasurisë *vetting*, trupi gjykues vlerëson se vërtetimet e shoqërive punëdhënëse të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, kanë vlerën e provës në lidhje me masën e pagës së dakordësuar mes punëdhënëseve dhe punëmarrësit, përfitimi apo jo i së cilës në lidhje me verifikimin e të ardhurave totale vjetore të përfituara, do të kryhet sipas depozitimeve në llogarinë përkatëse të pagës së z. F. Sh. Në këtë kontekst, trupi gjykues çmon se konkluzioni i Komisionit për deklarim të pasaktë të të ardhurave nga punësimi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, është i pabazuar në fakte. 75. Ndërsa sa i takon vlerësimit të ligjshmërisë së këtyre të ardhurave, në kuadër të standardit të vendosur nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht se nga hetimi rezultoi që për një pjesë të të ardhurave të krijuara nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk janë përmbushur detyrimet tatimore të parashikuara nga legjislati në fuqi, fakti që ky detyrim, referuar parashikimeve të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe të ligjit nr. 9136, datë 11.09.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, bie mbi palën punëdhënëse, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk mund të penalizohen në kuadër të procesit të rivlerësimit, në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së të ardhurave të realizuara nga punësimi, për sa kohë nuk provohet që mospërmbushja e detyrimeve të palës punëdhënëse ka qenë e ditur dhe, rrjedhimisht, e pranuar nga punëmarrësi. [...]

e tyre në masën e deklaruar nga personi i lidhur, duke ndryshuar tërësisht dhe nga situata e referuar nga vetë subjekti në vendimin nr. 35/2022 (JR), të Kolegjit.

**19.3.8.** Trupi gjykues i Kolegjit, në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se Komisioni duhej të kishte zbatuar të njëjtin standard të ndjekur nga Kolegji në vendimet nr. 19/2022 (JR) dhe nr. 20/2023 (JR), vlerëson se neni D i Aneksit të Kushtetutës, si dhe ligji nr. 84/2016, përcaktojnë qartë detyrimin e subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, për të provuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurive dhe të të ardhurave, të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*. Në këtë kuptim, pasuritë e krijuara nga personi i lidhur me subjektin, gjatë periudhës së bashkëjetesës, bëhen objekt kontrolli dhe, për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit ka detyrimin ligjor të vërtetojë bindshëm burimin e ligjshëm të krijimit të tyre. Vendimet e Kolegjit të sjella në vëmendje nga subjekti, paraqesin një situatë faktike dhe juridike të ndryshme nga ajo e çështjes konkrete, jo vetëm lidhur me momentin e krijimit të pasurive të deklaruara nga personat e lidhur, por edhe për shkak se pretendimet e subjektit mbi realizimin e të ardhurave për krijimin e tyre, mbetën tërësisht në nivel deklarativ. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit çmohet i pabazuar në ligj dhe në prova dhe, si i tillë, nuk pranohet.

**19.3.9.** Lidhur me pretendimin e subjektit *mbi shumën prej 1.000.000 lekë nga personi fizik "A. M." për vitin 2009, ku vetë Komisioni ka pranuar vlerën 400.000 lekë me metodologji alternative*, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim nuk qëndron pasi subjekti "A. M.", person fizik, me NIPT {\*\*\*}, me objekt aktiviteti *avokat*, rezulton i regjistruar në regjistrin tregtar më datë 11.02.2008, dhe i çregjistruar më datë 13.05.2009<sup>40</sup>. Komisioni ka përllogaritur fitimin e mundshëm nga ky aktivitet në shumën 400.000 lekë për katërmujorin e parë, duke konsideruar një qarkullim vjetor kufi në vlerën 2.000.000 lekë dhe marzh fitimi 80% të qarkullimit të parashikuar. Ndërkohë që kjo shumë, sipas deklarimeve të vetë subjektit në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe deklaratën e interesave privatë 2011 është deklaruar si burim krijimi të pasurisë apartament banimi të porositur në muajin janar të të njëjtit vit.

**19.3.10.** Sa i përket të ardhurës neto prej 400.000 lekësh, Komisioni ka vlerësuar se: *[...] duke qenë se personi i lidhur nuk ka deklaruar vlerë kursimesh cash në fund të vitit 2012, kjo vlerë nuk mund të mbartet në vitin 2014 e të përdoret si burim për derdhjen e kapitalit në shoqëri*. Nga ana tjetër, nuk mund të aplikohet e njëjta përllogaritje për të ardhurën nga personi fizik "A. M." me NIPT {\*\*\*}, i cili rezulton i regjistruar më datë 18 janar të vitit 2010, e në këto kushte, nuk mund të ketë realizuar të ardhura për vitin 2009, dhe për këtë arsye, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, nuk qëndron.

**19.3.11.** *Lidhur me diferencën prej 301.060 lekësh, referuar nga subjekti si diferencë në tabelën në faqen 42 të vendimit, ku pasqyrohet shuma 9.112.721 lekë, ndërkohë nga mbledhja matematikore rezulton se është 9.413.781 lekë*, trupi gjykues i Kolegjit në shqyrtim të analizës financiare të kaluar me rezultatet e hetimit subjektit të rivlerësimit nga Komisioni, konstaton se të ardhurat e personit të lidhur deri më shkurt të vitit 2011<sup>41</sup>, pra para bashkëjetesës kanë qenë në vlerën 5.688.935 lekë. Pas prapësimeve për rezultatet e hetimit, Komisioni ka ripërllogaritur mundësinë financiare të personit të lidhur, në vlerësim të shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej saj, nga e cila është korrigjuar

<sup>40</sup> Ekstrakti historik i personit fizik i administruar nga faqja elektronike zyrtare e QKB-së (çështja nr. {\*\*\*}).

<sup>41</sup> Komisioni ka verifikuar mundësinë financiare të personit të lidhur me subjektin, deri në shkurt të vitit 2011, për shkak të likuidimit të detyrimit për apartamentin e porositur me kontratë sipërmarrje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 11.01.2011.

vlera e të ardhurave të A. M. para bashkëjetese, në vlerën 9.112.721 lekë. Konstatohet gabim material në përllogaritjen e kësaj të ardhure, sa i përket përfshirjes dy herë të gjendjes së likuiditetit në shkurt të vitit 2011, apo përfshirjes në të, të vlerës 1.383.000 së automjetit “Volkswagen”, me targë {\*\*\*} të blerë nga A. M., me kontratë nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., 07.03.2010. Edhe nëse të ardhurave të personit të lidhur para bashkëjetesës, në vlerën 5.688.935 lekë, do t’i shtohen të ardhurat që subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim, kjo shumë nuk do të arrinte vlerën 9.413.781 lekë, sikurse e pretendon subjekti i rivlerësimit.

19.3.12. Sa i përket të ardhurës neto 105.000 lekë, që personi i lidhur ka realizuar nga Agjencia Kombëtare e Turizmit, konfirmohet nga aktet në dosjen gjyqësore që Komisioni e ka përfshirë atë në zërin “Të ardhura” të analizës financiare të rishikuar. Të ardhurat e tjera të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit për t’u përfshirë në analizë financiare të kontrolluar në Kolegj, janë trajtuar nga trupi gjykues në vlerësimin e shkaqeve të ankimit që lidhen me burimin e krijimit të aksioneve në shoqëritë “{\*\*\*}” dhe “{\*\*\*}” ShA.

19.3.13. Për rrjedhojë, edhe në konsideratë të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për realizimin e analizës financiare në mënyrë kumulative për periudhën 2001 – 31.12.2014, për sa kohë nuk u provuan dhe nuk u vlerësuan nga ana e trupit gjykues si të ligjshme: (i) vlera 10.000 euro apo 1.388.100 lekë që R. Z. ka transferuar në llogarinë e A. M. në Tirana Bank ShA, në vitin 2010; (ii) të ardhurat e pretenduara nga shoqëria “{\*\*\*}” ShA për periudhën 2005 – 2012, në vlerën 4.800.000 lekë; (iii) të ardhurat neto nga personi fizik “A. M.” me NIPT {\*\*\*}, për vitin 2011, në vlerën 600.000 lekë; (iv) të ardhurat neto nga personi fizik “A. M.” me NIPT {\*\*\*}, në vlerën 400.000 lekë, për vitin 2009; (v) të ardhurat nga shfrytëzimi i tokës bujqësore të pretenduara në vlerën 3.802.102 lekë, si dhe (vi) të ardhurat e pretenduara nga punësimi në zyrën avokatore “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën 770.371 lekë të cilat u konsideruan në analizë në masën e provuar me dokumentacion, në vlerën 513.580,66 lekë, të cilat janë marrë në konsideratë në masën e provuar me dokumentacion, në vlerën 513.580,66 lekë, balanca pozitive prej 5.970.115 lekë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, do të konvertohej në negative, në vlerën (-) 5276.877,34 lekë.

19.3.14. Nga kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për periudhën e rivlerësimit 2006 – 2016, kryer përmes Njësisë së Shërbimit Ligjor në Kolegj, bazuar dhe në vlerësimin më lart, trupi gjykues konstatoi mungesë të burimeve financiare të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur me të, për të justifikuar me të ardhura të ligjshme pasuritë e krijuara, shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara gjatë periudhës në analizë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim, trupi gjykues në Kolegj, mbështetur në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, e për pasojë, çmon se vendimi nr. 792, datë 04.09.2024, i Komisionit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 792, datë 04.09.2024, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Ornela Rrumbullaku.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 15.01.2026, në Tiranë.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*